




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në seancën e parë të Kuvendit të Komunës, më 30.1.2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2/1. Propozim vendimi për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit për vitin 2013,
 - 2/2. Propozim vendimi për miratimin e Orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe komiteteve të KK-s për vitin 2013,
 - 2/3. Propozim Rregullorja për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2013,
 - 2/4. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2012,
3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 9.00

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së parë të KK-së për vitin 2013 morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa

Përfaqësuesi i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OSB-së, z. Basri Sejdiu

Mediet

Seancën e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, Izmi Zeka i cili i përshëndeti, anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë dhe kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së parë të vitit 2013 ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit;

Procesverbali –

Arben Mehmeti- në procesverbal faqe 8 te diskutimi im për pikën 2.7, në të cilën është folur për ndarjen e mjeteve financiare për stadiumin e qytetit, ne e kemi lëshuar seancën për shkak se nuk na është dhënë mundësia për t' u debatuar për këtë pikë të rendit të ditës dhe jo që ajo u debatua më herët dhe ne jemi duke debatuar për një çështje të kryer. Unë kërkoj që të bëhet një përmirësim dhe në procesverbal të jetë se nuk na është lënë mundësia e diskutimit dhe e kemi lëshuar seancën. Nuk është kryer ajo më herët dhe që ne kemi kërkuar të ridiskutohet

Izmi Zeka- të deklarojeni se kush është për aprovim të procesverbalit me këtë vërejtje?

Aprovohet procesverbali me këtë vërejtje

Sadudin Berisha- kam një vërejtje jo të sotme, por të më parme e që nuk e kam thënë në seancën e KK-së se në faqen që udhëhiqet nga zyrtarët e KK-së në pjesën më të madhe nga debatet që janë bërë në KPF për pa i përjashtuar edhe disa komitete, nuk përcillen informacionet deri te opinionin publik. Kur e them këtë i kam parasysh tekstet të cilat përcillen.

Këto tekste janë shumë të shkurtra, tërësisht të paqarta dhe pozicioni që e mbajnë opozita në ato takime. Në pjesën dërmuese të tyre, informacioni del sikurse të gjitha çështjet që diskutohen aty miratohen e që nuk miratohen, por aty shqyrtohen dhe rekomandohen për diskutim dhe vendim-marrje në KK. Në shumë raste edhe diskutimi im epet sikurse edhe unë e kam miratuar, njërën, të dytën dhe tretën pikë edhe për ato për të cilat kam qenë kundër tyre. Përmendet vetëm emri si emër për pa i përjashtuar edhe kolegët e tjerë dhe me aq mbetet !

Ju lus jo korrektësi, por saktësi në informim të opinionit publik. KPF nuk aprovohen dokumente nëse nuk është deleguar ndonjë kompetencë KK komitetit përkatës deri më sot pos ato që i ka të garantuara me ligj nuk ka asnjë të drejtë të deleguar Prandaj ju lus mos e dezinformoni opinionin publik.

Izmi Zeka- në KPF, jemi pajtuar me këtë rend të punës, por edhe në dhjetor kemi kërkuar që në seancën e parë të jetë Raporti i kryetarit të Komunës.

Arben Mehmeti- ka qenë një kërkesë e mëhershme çështja e transmetimit të seancave publike dhe kjo është hera e pestë që keni dhënë premtime publike se kjo do të realizohet! Mirëpo sot po vërehet se nuk ka as transmetim të përkohshëm, kurse të përhershëm as që bëhet fjalë! Për neve kjo është shumë vërejtje serioze dhe është

kërkesë serioze e jona për shkak se është mundësia e Komunës për ta realizuar një gjë të tillë. Seancat duhet të transmetohen dhe të vendosen në faqen publike, faqen zyrtare të KK-së dhe ta ketë mundësinë secili të përcjelljes së seancave. Ne këtë kërkesë përsëri po e përsërisim në emër të grupit parlamentar të LDK-së që kjo t'iu mundësohet qytetarëve, sepse kemi obligime ndaj qytetarëve, janë taksa pagues të Komunës, prandaj kemi obligim për t'iu njoftuar mbi rrjedhat e seancave të KK-së. Ashtu siç vepron Kuvendi i Kosovës edhe KK e Gjilanit duhet ta bëjë një transmetim të tillë dhe kjo mos të konsiderohet si kërkesë jo serioze! Mandej Zyra për Informim e Komunës së Gjilanit i plason vetëm aktivitetet e njëanshme të Komunës së Gjilanit dhe zyrtarëve komunal, pa asnjë pasqyrim më të vogël të spektrit opozitar, prandaj kjo çështje është për shqyrtim serioz. Ne kërkojmë edhe njëherë që deri në seancën e radhës kjo kërkesë të plotësohet, sepse nuk është diçka e pamundshme.

Sokol Haziri- fillimisht grupit parlamentar të PDK-së ia uroj përfundimin e punës së Konventës së partisë duke i uruar punë të mbarë dhe uroj që sa më shumë gjilanas të jenë në organe drejtuese të partisë. E dyta unë i bashkohem kërkesës së Arbenit, sepse kjo ka qenë një kërkesë e përbashkët që ky Kuvend të përcillet dhe fjala jonë të mos mbetet vetëm brenda sallës, por të dëgjohet edhe te qytetarët. Më mirë të transmetohet se sa të përcillet parciaisht siç ka ndodh me KPF-në për të cilin takim ka qenë një raportim katastrofal i TV-së. Për këtë arsye është mirë që të gjendet një mundësi dhe të përcillen seancat e këtij Kuvendi.

Izmi Zeka- të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij rendi të punës?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

2/1. Propozim vendimi për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2013,

2/2. Propozim vendimi për miratimin e Orarit të mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve të KK-s për vitin 2013,

Izmi Zeka- në rend të punës janë dy pika të cilat janë të ngjashme me njëra tjetrën për të cilat është debatuar në KPF dhe janë bërë disa vërejtje nga opozita të cilat kanë qenë shumë korrekte të cilat vërejtje i kemi marrë parasysh dhe e kemi bërë atë plotësim. Është një vërejtje për drejtorët (disa prej tyre), sepse nuk e kanë sjell në kohën e duhur Planin e punës për t'iu debatuar në KK. Këtë e ka bërë Drejtoria e Urbanizmit, por të tjerat jo, prandaj duhet t'iu sjellin të gjitha drejtoritë për t'iu përplotësuar ky plan i punës për vitin 2013. Me kalimin e kohës besoj se këto plane do të sillen dhe do të kompletohen, por këto janë plane të punës vetëm orientuese në vija të trasha, sepse do të paraqitet nevoja për plotësime të tjera edhe për orarin e punës edhe për planin e punës për vitin 2013.

Sadudin Berisha- në KPF, unë kam qenë ai që, jo që e kam kritikuar, por e kam thënë një projekt –plan të punës për vitin 2013. Plani i cili na është ofruar është tepër i mangët dhe nuk dihet cili është objektivi dhe angazhimi i Qeverisë Komunale dhe i Kuvendit. Ne i kemi drejtoritë që duhet ta udhëheqin në mënyrë profesionale punën në suaza të kompetencave

dhe përgjegjësi dhe nuk kemi parë se cilat janë objektivat e atyre drejtorive, veçmas ato të cilat janë të fokusuara në investimet kapitale në angazhimet dhe në zbatimin e ligjit në Komunën e Gjilanit. Shoh se ka disa përmirësime dhe mos të harrojmë se jeni në vitin e fundit të mandatit tuaj qeveritar dhe premtimet e juaja nuk janë realizuar nga ato që i keni premtuar tash e 4 vite më parë! Ne mund të kalkulojmë me shifra me numra, me numrin e të punësuarve dhe paushallëve të shumta, por ky plan ka qenë desh të jetë shumë fish më dinamik, më shumë harmonizues dhe më shumë në interes të qytetarëve, por që kapacitetet e juaja nuk lejojnë më shumë se që është ofruar.

Zijadin Maliqi- unë jam munduar për ta analizuar këtë plan të punës dhe mendoj se ka edhe gjëra të tjera që duhet të hyjnë në këtë plan. Unë mendoj se pjesë e këtij Plani të punës duhet të jetë edhe raporti nga ndërmarrjet publike “Eco-higjiena”, ku e kam parë se në nëntor duhet të epet një raport, por me ligj ndërmarrjet publike sidomos “Eco-higjiena” e cila është në kuadër të Komunës duhet ta jep edhe raportin vjetor.

Raporti vjetor në nëntor nuk epet, por unë mendoj që ai duhet të epet më së larti në muajin mars si raport i punës së “Eco-higjienës”. Ndërmarrja tjetër “Hidromorava” është mirë që ta jep një informatë edhe pse është në kompetenca të Qeverisë së Kosovës, gjithashtu më së largu deri në fund të muajit mars. Këto ishin vërejtjet e mia, iu falënderoj për mirëkuptim.

Izmi Zeka- sa për informatën e juaj po e them se MPL të gjitha raportet që i ka bërë kanë qenë shumë pozitive për KK të Gjilanit dhe Gjilanin. Ky është raport zyrtarë, kurse nganjëherë ka edhe çështje politike, marketing etj.

Ne si pushtet e kemi obligim për të vazhduar me punë, kurse opozita e ka të drejtën për të kritikuar edhe kur diçka është me vend, sepse në demokraci lejohet edhe kjo.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë dhe kryesuesi propozoi që të aprovohen të dy këto pika të rendit të punës?

Izmi Zeka- kush për aprovim të pikës 2/1 dhe 2/2?

Aprovohet pika 2/1 dhe 2/2 e rendit të punës: **2/1.** Propozim vendimi për miratimin e Planit të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2013, dhe **2/2.** Propozim vendimi për miratimin e Orarit të mbledhjeve të Kuvendit dhe komiteteve të KK-së për vitin 2013, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjërin variant të votimit.

2/3. Propozim Rregullorja për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale për vitin 2013,

Kryesuesi i Kuvendit lidhur me këtë pikë fjalën për arsyetim ia bartë zyrtarit ligjor, z. H. Matoshi.

Hevzi Matoshi- në pajtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, Komuna e Gjilanit ka rishikuar tarifat dhe ngarkesat komunale për vitin vijues 2013 dhe si rrjedhim i kësaj me datën 19.11.2012 është organizuar dëgjimi publik për projektin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale.

Duke pasur parasysh propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet e pranuar nga dëgjimi publik dhe rekomandimet e sugjerimet e ardhura nga institucionet tjera relevante që e ndihmojnë zhvillimin ekonomik të Komunës, Ekzekutivi i Komunës ka bërë një analizë të të gjitha tarifave dhe ngarkesa dhe ka nxjerrë këto përfundime:

1. në DAP nuk ka ndryshime të tarifave dhe taksave do të jenë të njëjta si në vitin 2012.
2. në DBF ka një lëvizje të taksave komunale lidhur me biznesin ku ato tani menaxhohen nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik. Për vitin 2013 duke pasur parasysh kërkesat e bizneseve, do të mbesin vetëm taksat për bizneset monopoliste.
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike, nuk ka në esencë ndryshime të mëdha përpos disa modifikime apo formulime.
Te tarifa:
 - 3.9 shtohet pika c) përcakton taksën për leje për ndërhyrje në infrastrukturë pa prerje të asfaltit (shpim),
 - 3.16 ka një harmonizim të tarifave (30- 40% dhe
 - 3.17 nga 200-100€),
 - 3.22 tarifë e re,
 - 3.32 ka harmonizim të tarifave (pika d) 8-10 dhe pika e) 4-8),
 - 3.34 ka një harmonizim të tarifave (pika a) 20-30, tarifa tjera b,c, d dhe e) zbriten,
 - 3.35 harmonizim (15-20 dhe 25-30),
 - 3.39 harmonizim (100 – 150 dhe 200- 300),
 - 3.49 harmonizim – zbritje (20-15, 12-8, 6-4),
 - 3.51 tarifë e re për depo të nxehjes qendrore,
 - 3.52 modifikim të kësaj tarife,
 - 3.53 tarifë e re
 - Paragrafi 5.14 (e re) përcakton dispozitën me të cilën parashihen përjashtime nga pagesa për bizneset prodhuese në komunë.
4. Drejtoria e Urbanizimit- nuk ka ndryshime në tarifa për shërbimet që i ofron, për një kohë do të operohet me taksa të vjetra për deri sa nuk kalkulohen dhe përcaktohen taksave administrative për dhënien e lejes së ndërtimit në pajtim me metodologjinë që përcakton ligji i ndërtimit. Sipas ligjit të ri nr. 04/L-110 taksat në sferën e ndërtimit do të për leje ndërtimore, për infrastrukturë dhe densitet.
5. Drejtoria e shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale – nuk ka ndryshime përpos që janë inkorporuar në këtë projekt të rregullore edhe tarifat për shërbimet që ofrohen nga QPS-ja, (neni 7 parag. 1 tarifat 5.91 – 6.01)
6. Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronës - nuk ka ndryshime sepse të gjitha tarifat e drejtorisë janë të përcaktuara me udhëzimet përkatëse. Në paragrafin 10.2 pika d) ka riformulim dhe në paragrafin 10.5 bëhet një përjashtim sa i përket zbatimit të tarifave të përcaktuara në paragrafi 10.2 dhe 10.3 në rastet kur vije në pyetje zbatimi i ligjeve në fuqi për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale dhe për PPP.

7. Drejtoria e Bujqësisë – nuk ka ndryshime në taksa sa i përket vitit 2013.

8. Në nenin 11 të projekt – rreg. janë të inkorporuara edhe tarifat për shërbimet që ofrohen në palestër sportive dhe stadium të qytetit (tarifa 9.18 dhe 9.19).

Duke pasur parasysh këtë që u referua i propozoj KK-së që të miratojë Rregulloren për vitin 2013 e cila në mënyrë retroaktive do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2013.

Arben Mehmeti- lidhur me këtë rregullore është një vërejtje serioze për Zyrën Ligjore, sepse kjo rregullore ka qenë desh të kalojë në Komisionin për Akte Normative i cili është themeluar nga ky Kuvend dhe nuk duhet të lejohet asnjëherë që një rregullore të sillët për debat në Kuvend, për pa u rekomanduar nga ky komision. Kjo është praktikë edhe në Kuvendin e Kosovës dhe në të gjitha institucionet, prandaj për pa e marrë vizën aty as që ka qenë desh të debatohet këtu në këtë Kuvend. Mirëpo besoj që herëve të tjera, Zyra Ligjore do ta ketë, këtë fakt dhe mos të lejojë që të vijë këtu një rregullore dhe një dokument i rëndësishëm për pa kaluar nëpër atë komision që është profesional.

Pasi ta shqyrtojë komisioni, kryesuesi e bën me shkrim një arsyetim të cilin ia bashkëngjit rregullores, pastaj të vijë këtu për debat.

Zyra e ka aspektin administrativ, por Komisioni për Akte Normative e luan rolin e këtij Kuvendi dhe për pa kaluar në atë procedurë, ne nuk duhet të lejojmë që të debatohet këtu.

Shefi i Zyrës Ligjore e lexoi një arsyetim juridik të cilin ne nuk e kemi dhe të cilin ka qenë desh ta kemi, por është kërkesë që në të ardhmen mos të lejohet kjo nga ana e kryesuesit. Unë nuk kam për të thënë shumë për këtë rregullore, sepse ka njerëz më profesionistë, por nga praktika që kam pasur rastin që e kam nxjerr një dokument në Komunë, por me gabim të zyrtarit më është desh prapë të shkoj në Komunë për ta bërë përmirësimin dhe më është desh për ta bërë pagesën për të dytën herë.

Kjo nuk duhet të lejohet, sepse zyrtari komunal i një drejtorie përkatëse ka gabuar në hartim të një dokumenti i cili dokument nga gjykata më është kthyer prapa për shkak të një gabimi teknik. Mua më është desh të bëj rikërkesë për ta rregulluar atë dokument dhe për ta paguar përsëri 5 euro. Për këtë arsyeje në kuadër të rregullores duhet të parashihet një pikë që me gabim të zyrtarit komunal, qytetari për të dytën herë nuk ka obligim të bëjë pagesë. Po ashtu kam vërejt edhe një të metë tjetër e cila është për shkresat zyrtare që bëhen nga zyrtarët e komunës, këshilltarëve të komunës, drejtorëve duhet të jetë pjesë e rregullores që për shkresa zyrtare që e drejton një anëtarë i Kuvendit ajo duhet të jetë gratis, sepse anëtarët e Kuvendit i përfaqësojnë qytetarët nëse e adresojnë një shkresë në emër të qytetarëve.

Sokol Haziri- po pajtohem menjëherë me Arbenin për atë që e tha, sepse ky është një komunikim i brendshëm, nuk është një komunikim i qytetarit me institucione, por është një komunikim i brendshëm. Ne jemi pjesë e strukturës së pushtetit në nivel lokal, prandaj kjo është për t' u debatuar dhe është një interpretim i asaj se çfarë duhet të ndodh.

E dyta ne kemi dhënë mbështetje për rregulloren në KPF, por përfaqësuesi i Zyrës Ligjore tha se do të ketë veprim retroaktiv për 2013, nuk shoh ndonjë efekt 2013, kjo do të duhej të kishte veprim retroaktiv në kuptimin e plotë të fjalës sipas atyre rregullave të drejtësisë se ligji më i favorshëm është i aplikueshëm për ata që iu adresohet dhe në këtë rast se ky veprim retroaktiv të jetë i papërcaktuar në kohë, sepse ka ndoshta ndonjë biznes i vogël i cili nuk ka funksionuar, kurse është ngarkuar me taksa dhe natyrisht ato taksa nuk mund të inkasohen.

Ne si grup politik, kërkojmë që të merret në konsideratë kjo kërkesë e jona që të ketë veprim retroaktiv në përgjithësi.

E dyta u vërejt dhe u tha qartë, vërejtjet tona që i patëm si AAK në KPF, që kompanitë që kanë monopol mos të jenë të barabarta, siç është 1 mijë euro për Kosovatransin, njësoj sikur për KEK-un ose PTK-në. Kapacitetet e Kosovatransit, të PTK-së, KEK-ut dhe të bankave dihen, prandaj nuk i pash dhe kërkoj një sqarim më të detaj. Dua ta di a janë marrë parasysh këto vërejte tona në mënyrë që të ketë dallim esencial në mes këtyre shembujve, por mund të ketë edhe të tjera.

Ejup Haziri- unë e kam vetëm një kërkesë për sqarim për drejtorin e Shërbimeve Publike te pika 3.44- është shtrirja e rrjetit kabllor të internetit për metër gjatësi, 1 (një) euro për metër gjatësi. Sipas informacioneve që kemi në komunat fqinje është 10 cent për metër gjatësi. Do të thotë është dhjetë fishi i asaj që është përcaktuar atje. A ka ndonjë gabim apo është saktë 1 euro?

Arben Maliqi- grupi i ynë e ka analizuar këtë rregullore dhe në parim e mbështesim dhe njëkohësisht e kemi një falënderim për ata të cilët kanë punuar në këtë rregullore, sepse jemi të vetëdijshëm se bizneset e mëdha i kanë ngulfat ato të voglat dhe ajo taksë e cila iu ka heq është shumë e mirë për qytetarët. Kështu që ne në parim e mbështesim

Tefik Ibrahim- unë më tepër po paraqitem në emër të bizneseve dhe të partisë dhe është një falënderim nga ana e bizneseve për heqjen e taksës. Në këtë kohë të rëndë për bizneset është një lehtësi e madhe dhe konsideroj se duhet falënderuar për atë premtim që është dhënë edhe më herët i cili tash është realizuar. Për këtë iu takon një falënderim në emër të bizneseve.

Arianit Sllamniku- unë po ndalem te dy blloqe të tarifave, te 4.1 dhe 2.6 deri në 2.8, bankat, bingot, kazinot dhe te institucionet mikro-finaciare. Për mendimin tim të gjitha këto institucione janë përfituese të drejtpërdrejta të qytetarit të cilat institucione ditë e për ditë më shumë po shtohen. Mirëpo po shtohet edhe rreziku i dështimit të familjeve në komunën tonë. Unë nuk e di prej nga është marrë baza e tatimit të ndryshëm në kuadër të këtyre 4 kategorive. Për mendimin tim të gjitha janë të njëjtë nivel. Te çështja e marketingut te blloku tjetër i tarifave ne kemi ngritje mjaft të madhe dhe propozimi im kishte me qenë që këto të relaksohen, sepse në këtë mënyrë duhet të ofrohen si biznese të jashtme të cilat nuk janë të pranishme në komunën tonë.

Ne gjatë tërë kohës jemi thirr në promovimin e lirisë së Komunës dhe veprimtarisë së aseteve ekonomike, por promovimin e tyre e kemi sanksionuar. Kjo është një formë e cila e sanksionon edhe biznesin. Unë iu propozoj që sa më shumë hapësirë bizneseve në promovimin e tyre. Pika tjetër është një kërkesë 10 euro, për një çështje tejet të thjeshtë të qytetarit për një kërkesë i cili qytetarë është taksapagues i saj. Për mendimin tim kërkesat i kisha lënë që të shqyrtohen nga institucioni, qytetari që është taksapagues i saj unë i kisha lënë falas. Në sferën e Urbanizmit 6.1, janë kërkesa të thjeshta, 10 euro një kërkesë për çështje ambientale dhe në aspektin ambiental ne nuk e kemi asnjë pikë të drejtorisë përkatëse. Iu lus që këto pika të jenë sa më atraktive sa më relaksuese dhe për gjendjen ekonomike në Komunën tonë.

Zijdin Maliqi- përveç vërejtjeve të cilat i dha edhe Arbeni rreth atyre procedurave, vërejtja e jonë e grupit të këshilltarëve është në atë që kjo rregullore është e vonuar në kohë.

Po përfundon janari, kurse rregullorja sot po debatohet. Rregulloret të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në planifikimin e buxhetit është mirë që të planifikohen me kohë si kjo ashtu edhe rregullorja mbi tatimin në pronë të cilat duhet të aprovohen para aprovimit të buxhetit e që në planin e punës ishte për këtë vit.

Edhe ne e përkrahim lirimimin e bizneseve nga taksat i cili është një gjest i mirë dhe përveç pikave të mbetura në tarifën 2 e kemi parë që nuk ka dallime shumë nga rregullorja e cila ka qenë e aprovuar edhe më parë. Janë bërë disa lirime për të cilat taksa jemi edhe që të lirohen, por në disa pika kemi edhe disa rritje në krahasim me atë që ka qenë të cilat po i përmendi. Unë po i përmendi disa dhe po propozoj që të kthehen në gjendjen në të cilën kanë qenë siç është pika 3.33, kemi një rritje nga 30 euro në 40 euro. Mandej është pika 3.35 edhe këtu kemi një rritje prej 15 euro në 20 në a, kurse nën b nga 20 në 25 euro. Ne mendojmë se këto duhet të mbesin ashtu siç kanë qenë.

Te pika 3.16 kemi rritje prej 30% në 40%, te pika 3.39 edhe këtu nën a dhe nën b kemi një rritje prej 100 euro në 150 euro dhe pika b. Nga 200 euro në 300 euro. Mendoj se këtu është një rritje bukur e madhe. Te urbanizmi te pika 4.14 ka qenë 5 euro kërkesa për lëshimin e vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve, kurse tash është 10 euro.

Gjithashtu kemi edhe te pika 8.3 te Kadastri ndarja e një parcele në dy pjesë nga 50 në 75 euro. Këto janë ato që unë i kam evidentuar si rritje dhe që unë propozoj që ato të kthehen si kanë qenë, por po të kishte mundësi edhe të zbritën.

Këto janë vërejtjet tona për ndryshe ne e përkrahim këtë rregullore.

Leonorë Bunjaku- unë po e ngrit çështjen e qirasë për shfrytëzim të pronave Komunale, sepse të gjitha lokalet komunale me material të fortë ndërtimor si lokale afariste qiraja mujore për m², është si vijon: Zona “A-3” është 4 euro, zona “A-2”, 8 euro dhe zona “A-1”, 15 euro. Në emër të grupit dhe të disa qytetarëve të cilët e gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre lokaleve e lus KK-në që të ketë parasysh dhe të bëjë zbritje në zonën “A-1”. Kërkojmë që të merret parasysh edhe ky sugjerim, sepse gjendja e afaristëve gati se është e mjerë. Mirëpo kryetari në seancat e më parme e ka premtuar këtë iniciativë, nëse gjendja e tyre ekonomike nuk mund t’ i përballojë kësaj pagese, do të kemi konsideratë ndaj kësaj çështje. Unë kam informatë se gjendja është shumë e rëndë dhe asnjëherë nuk kanë qenë afaristët në gjendje më të rëndë! Ju lus ta keni mirëkuptim dhe në këtë rast të ketë zbritje në 12 euro.

Abdyl Aliu- gjatë arsyetimit të rregullores e kam vërejt një çështje te kjo rregullore në nenin 5 (qiraja për shfrytëzim të pronës komunale), pika 5.12.f (për të gjitha objektet e ndërtuara me material të fortë në pronë komunale e të cilat Komuna e trajton si uzurpime, shfrytëzuesi i paligjshëm i tyre do të ngarkohet me një gjobë 100%, kurse çmimi në bazë të tarifës 3.49, paragrafi 5.1 i kësaj rregulloreje). Mendojmë se nuk do të duhej këtu të kërkohej qira nga Komuna. Ajo çka duhet të bëjë Komuna në këtë rast është që duhet ta rikthejë atë pronë komunale dhe jo të marrë qira nga uzurpimi! Në këtë mënyrë Komuna e legalizon uzurpimin dhe bëhet bashkëpunëtorë me uzurpuesin dhe në këtë mënyrë mendoj se do t’ i stimulojmë edhe uzurpimet e tjera.

Florinë Zymberi- unë desha të them diçka lidhur me taksat për kontrollime teknike, sepse taksa prej 500 eurove është një shumë e madhe, sepse nuk është një biznes fitim prurës

dhe në raport me bankat dhe sidomos me ato që e bëjnë sigurimin e automjeteve është dallim shumë i madh. Unë kërkoj që kjo taksë të zbres dhe të mos mbetet aq e lartë ashtu siç ishte paraparë.

Arben Mehmeti- është mirë që këshilltarët komunal të kenë kujdes me kërkesat që kanë të bëjnë me aspekt personal, sepse rasti i fundit është konflikt interesi, por edhe disa raste të mëhershme. Kështu që ky Kuvend, kërkesat që kanë të bëjnë me çështje personale nuk duhet t' i merr parasys.

Tjetër është se afër LDK-së në ndërkohë na është paraqitur një problem dhe po e shfrytëzoj këtë rregullore mbi taksa dhe gjoba (është Kulla e Sahatit) të cilën në kohë të fundit PDK dhe Vetëvendosje po e përdorin për marketing. Është mirë të parashihet një taksë edhe për atë objekt dhe le të shfrytëzohet për marketing edhe prej institucioneve të tjera, bizneseve dhe prej atyre burimeve mund të rregullohet, sepse si po ecin punët ajo nuk do të rregullohet fare. Të parashihet një burim i financimit dhe të përfundojë njëherë e përgjithmonë dhe kjo iniciativë na ndihmon edhe neve si LDK, por i ndihmon edhe bizneset që janë aty afër, sepse kemi vërejtje nga ato biznese, sepse ajo është shndërruar në një deponi të egër. Është mirë që të parashihet një taksë e vogël aty dhe le të reklamojë cili do që dëshiron dhe ato taksa ta kenë dedikimin për rregullim të Sahat Kullës.

Qemajl Mustafa- unë do të lëviz pak nëpër këtë rregullore të taksave dhe ngarkesave për ta dhënë një kontribut minimal. Së pari t' i them se rregullorja që dy vite me radhë fillon herët për t'u hartuar dhe këto dy vite kanë dalluar nga vitet e më parme.

E çmoj atë vërejtjen e Zijadinit, lidhur me atë si disa taksa janë diku më lartë e diku më poshtë dhe unë nuk po pretendoj të them se 100% ia kemi qëlluar, por jemi munduar maksimalisht për të qenë secilën herë më të mirë se sa një vit më parë. Gjithashtu e çmoj atë konstatimin se është akt i vonuar kjo që po ndodh sot, sepse do të duhej të ndodh sikurse edhe aprovimi i rregullores për tatimin në pronë para miratimit të buxhetit.

Ne tash e kemi cenuar buxhetin e Komunës së paku me afër 200 mijë euro kur i kemi heq taksat e bizneseve (kushtimisht po e them e kemi cenuar, sepse tatimi në pronë është rritur dukshëm më shumë dhe planifikimi nuk e ka përcjell rritën ligjore. Planifikimi prapë është dukshëm më i ulët se sa në fakt do të ndodh faturimi për vitin 2013.

Taksa e ndërtimit ka mbetur prapë e njëjta, por më bëri përshtypje kur e tha Hevziu se i kemi taksur bizneset monopoliste. Ne nuk dimë a kemi biznese monopoliste dhe nuk është detyrë e jona për ta konstatuar këtë, sepse është një komision, janë disa ligje dhe akte që e rregullojnë atë fushë. Mirëpo ne në fakt i kemi liruar të gjitha bizneset për t' i taksuar bizneset të cilat kanë shtrirje nacionale e të cilat janë kryesisht shërbyese, tregti, janë bankat, sigurimet dhe ndërmarrjet publike. Në këtë funksion e pashë që kanë mbetur poshtë këto filialet e sigurimeve dhe mendoj se është shumë e ulët ajo 300 euro dhe shumë simbolike, prandaj mendoj se do të duhej të jetë 500 euro.

Po iu thërrasë të gjithëve që të vijnë në debate, të vijnë në proces të gjithë edhe pushteti dhe opozita dhe Kuvendit nuk do të duhej sot të merret me atë se do të duhej një taksë të jetë më e ulët apo më e lartë? Kjo rregullore duhet të jetë e harmonizuar dhe në Kuvend vetëm për ta formalizuar.

Arbeni the se duhet të kalojë nëpër Komisionin për akte normative, por ju e dini që ky komision nuk është aspekt ligjor, as statutar! E kemi themeluar ne për funksionuar më mirë,

për ndryshe, statutare është Zyra Ligjore e Komunës dhe ajo duhet të merret me këtë punë, KPF, ose ndonjë komitet tjetër dhe këto janë statutare dhe ligjore dhe KK.

Leonora e theksoj çështjen e këtyre qirave, te zonat 4, 8 dhe 15 euro, ne atë zonën e parë e ulëm prej 20 në 15 euro. Ju them shumë sinqerisht dhe me përgjegjësi e them po të ishin lokalet e tyre (unë kam pasur rast të takohem me ata) me siguri nuk do t' i kishën dhënë me 15 euro. Ju lus bëheni ju të gjithë që jeni të pranishëm në pozicionin e pronarit të atyre lokaleve? Nuk do t' i kishit dhënë, por pasi ato janë të publikut dhe do të duhej respektuar një normë tjetër, sepse Ligji për prokurim publik e parasheh. Shitja e aseteve publike dhe dhënia me qira bëhet me ankand. Nëse i qesim në ankand a do të kishin këto qira në qendër të qytetit a do të ndalen te qiraja 15 euro për m²? Unë mendoj se jo dhe nëse ia lëshojmë konkurrencës së lirë do të vërtetohet se do të shkojë shumë më lartë se 20 euro, prandaj këtu kemi qenë shumë të kujdesshëm.

Te ndërmarrjet publike që u tha të kthehen? Ne në komitet u morëm vesh që ato të jenë më të ulëta dhe Sokoli sot e tha, por unë mendoj se ato duhet të sillen së bashku me këto përfaqësimet e sigurimeve deri në 500 euro? Nuk po i dallojmë le të jenë njësoj si “Eco-higjiena”, “Hidoromorava” etj, por të jenë aty diku.

Puna e Sahat Kullës ishte një “humor” i mirë i cili më pëlqej shumë dhe na relaksoj Arbeni! Sahat Kullën e sqaruam këtyre ditëve se ishte një sulm i Vetëvendosjes për të bërë përpjekje për ta diskredituar Komunën. Ajo nuk është investim i Komunës, por Komuna e ka dhënë tokën dhe të gjithë kemi qenë në ngjarje dhe ka qenë investim i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në kohën kur ministër ishte Luftfi Haziri dhe zëvendëse ishte Lirie Kajtazi.

Mirëpo ka qenë edhe një mosmarrëveshje që gjëja investimi ka qenë 60 mijë euro, ne e gjetëm që kontrata ka qenë 41 mijë euro, kurse 80 mijë euro ka qenë të zotuar për atë projekt, por konkurrenca e ka bërë të vetën dhe ka ardhur në 41 mijë euro. Për fat të keq ju po e shihni se ajo ende nuk është kryer, është punishte. Ne nuk e kemi pastruar, sepse për mua është objekt i papërfunduar se si ia bën Ministria e Kulturës së bashku me ata që e kanë obligim që e kanë filluar atëherë është çështje tjetër, por kryesorja ajo është objekt i papërfunduar. Mirëpo ai është objekt i publikut të Komunës dhe nëse përdoret për marketing përsëri për shaka po e them taksat i takojnë buxhetit të Komunës dhe jo LDK-së.

Kjo është ajo që desha ta them dhe nuk do të duhej të merremi shumë me disa gjëra si i tha Arianiti, sepse ato janë taksa të veçanta.

Unë iu lus që ta votojmë këtë rregullore me këto ndryshime të vogla te shërbimet publike të cilat i tha edhe Zijadini të cilave me kujdes iu kemi qas dhe diku kanë qenë taksa me të vërtetë të vogla. Duhet të jemi shumë konciz derisa të vijë kjo rregullore në Kuvend, sepse sot nuk ka shumë hapësirë për të propozuar që diçka të ngritim ose zbresim!

Leonore Bunjaku- unë desha edhe një ndërhyrje te kjo pikë, sepse unë si qytetare e kësaj komune nuk jam për atë që Komunës t' i bëjmë dëm dhe t' i ndihmojmë një grupi të vogël të qytetarëve që i shfrytëzojnë këto lokale afariste. Mirëpo edhe sikur ta shpallim në ankand publik dhënien e këtyre lokaleve, unë jam në dyshim se cili prej bizneseve sot mund të përballohet me një qira të tillë? Me sa e dimë ne, ata punojnë vetëm sa për të mbijetuar nuk janë duke pasur ndonjë fitim të madh! Për këtë arsye ju lus që ta keni në konsideratë edhe njëherë këtë propozim për të pasur zbritje, sepse ata janë duke u përball me një krizë shumë të madhe.

Arben Mehmeti- kryetari nuk u përgjigj në një vërejtje e cila është lidhur me atë të gabimeve që i bëjnë zyrtarët në shkresat zyrtare. Nuk pat qëndrim për këtë, prandaj ia vlen për ta pasur një qëndrim si kryetar komune.

Tjetra është për Komisionin për akte normative në çastin që krijohet nga KK është akt statutar. Zyra Ligjore është e krijuar nga ky Kuvend dhe e ka epitelin si zyre e këtij Kuvendi. Çdo akt që krijohet në këtë Kuvend e ka fuqinë statutare. Ai quhet Komision për akte normative dhe akt normativ është rregullorja. Askush nuk mund ta thotë ndryshe këtë përveç atyre që nuk e njohin fushën juridike. Kjo është rregull e shkruar që praktikohet në institucionet më të larta. Tjetër nuk u përmend nga kryetari çështja e uzurpimeve e cila është shtruar nga ana e jonë këtu. Në asnjë mënyrë Komuna nuk guxon të hyjë në arazhmane me uzurpatorët. Në çastin që hy në këso arazhmane bëhet edhe Komuna njëlloj uzurpatori dhe për këtë ka përgjegjësi penale. Neve na është desh të na ofrohet lista këtu se çka është duke u punuar në këtë drejtim ? Cilat janë mekanizmat e kontrollit, cilat janë mekanizmat sanksionues, sepse duhet të ketë sanksione në këtë drejtim.

Edhe investimi te Sahat Kulla, kryetari dhe pushteti po thirren se ka gabuar Vetëvendosja, por unë po them se nuk ka gabuar, por ka gabuar Komuna që në broshurën e investimeve i ka paraparë 80 mijë euro. Edhe këtë duhet ta pranojë kryetari i Komunës dhe ta thotë që ka qenë gabim i yni që ne kemi publikuar aty duke desh që të krijojmë investime të mëdha para qytetarëve. Më vonë do të dalin probleme sikur që do të dalin edhe probleme të tjera të kësaj natyre. Ka qenë mirë të thuhet se gabimi ynë që kemi vendos në broshurë investime fiktivee të cilat nuk kanë ndodhur, por janë ëndrra për të ndodh në të ardhmen.

Florinë Zymberi- unë dua t' ia jap një përgjigje Arbenit, sepse lidhur me propozimin tim e tha se është konflikt interesi, por dihet se në Komunë të Gjilanit janë katër kompani të cilat merren me kontrollime teknike të automjeteve. Unë nuk kam folur në emër timin personal, sepse unë këtë nuk e kam biznes primar, por kam edhe biznese të tjera. Mirëpo këtu edhe tri kompani të tjera kontrollimin teknik të automjeteve e kanë veprimtari primare. Nuk mund të krahasohet një kontrollim teknik me një sigurim të automjetit. Siguria e automjeteve është 200-300 euro, kurse kontrollimi teknik pa tatime 20 euro për automjet. Të jetë e qartë ato biznese nuk mund të krahasohen me kontrollime teknike.

Sabedin Kadriu- nuk ka propozime, por e kam një vërejtje që nga dita e parë prej konstituimit të Kuvendit dhe po vazhdon kështu. Ne jemi anëtarë të Kuvendit dhe secili ka të drejtë për të bërë propozime të cilin propozim, realisht dhe moralisht duhet ta hidhni në votim. Unë jam i mendimit që çdo propozim i çdo këshilltari pa marrë parasysh se çfarë propozimi është ai dhe nëse është nevoja 50 herë do të votojmë për mos ta lënë procedurën mangu. Këtu po del një propozim, tjetri po e jep një mendim të kundërt dhe po harrohet.

Unë jam për atë që çdo propozim i këshilltarit të del në votim. A aprovohet apo jo, për atë vendos Kuvendi? Unë po flas drejtpërdrejtë dhe nëse del në votim propozimi i Leonorës jam për, bile edhe atë për ta zbritur në 10 euro. Unë thjeshtë jam për ta hedh në votim çdo propozim të këshilltarit, edhe atë dokumentin me gabime taksën për të dytën herë jo t' ia heq kryesuesi ose kryetari, por duhet marrë vendim ne.

Izmi Zeka- kjo nuk do debat, nëse për gabime teknike lëshohet një dokument dhe është paguar për të dytën herë, kjo është gabim. Nuk mund për një gabim të administratës pala të kthehet dhe të obligohet për të bërë edhe njëherë pagesën! Kjo nuk guxon të ndodh.

Ndërsa këtu janë 41 këshilltarë dhe secili ka propozime të ndryshme, ndërsa çështja e qirasë në qytet, vetëm shikoni çmimin e tregut dhe nuk mund të zbresim nën këtë çmim.

Qemajl Mustafa- së pari po e them një fakt e që nuk po e thotë askush se me vite të tëra mbi 10 vite i kanë shfrytëzuar këto lokale tepër lirë. Askush nuk po e thotë dhe nuk po e falënderon Komunën se lokale të tilla ka pasur me qira edhe 6 euro për m². Tash kur kemi arrit te çmimi i tregut po thonë është shumë, por askush nuk po thotë ka qenë banalisht lirë. Duhet dhënë pikë kësaj pune, nuk është KK- ai i cili përveç taksave të shërbimeve, nuk është KK, ai që vendos çmim për qira! Është ligji, me ligj kjo punë është e rregulluar, shpallet ankand dhe epet. Do të duhej dhe kështu ka me ndodh do t' i shpallim në ankand.

Kur është fjala e uzurpimeve janë raste kur pronarët kanë në një pjesë legalitet dhe në një pjesë tjetër nuk kanë legalitet. Do të thotë ose janë zgjeruar ose e kanë ngrit edhe një kat më lartë etj. Për këtë kemi pretenduar që përderisa nuk i duhet Komunës. Për ndryshe në secilin minutë që i duhen komunës ato duhet të anulohen, por për derisa nuk i duhet, është e nevojshme të caktohet një qira dhe atë jo normale, por dyfishin e qirasë.

Taksa te gabimet është shumë normale, ajo duhet të thuhet në rregullore për të funksionuar më së miri, për ndryshe është aspekt normal dhe do të duhej me një rutinë mos ta taksojmë qytetarin të cilit i lëshohet dokumenti me gabime. Gjithashtu nuk do të duhej për t' i marrë taksë këshilltarit, grupit, drejtorit, zyrtarit i cili paraqet një kërkesë për interes publik. Kjo duhet të thuhet në rregullore, unë jam për këtë!

E pranoj që te ajo fletushka e jonë për investime 4 vjeçare ka pasur ndonjë lëshim. Ne gjatë tërë kohës kemi thënë që kanë filluar, kanë mbaruar në ndërkohë dhe kanë filluar dhe janë në zbatim e sipër. Nuk mund të qesim vija në mes të mandateve qeverisëse.

Riad Rashiti- gjatë debatit e vërejta se është keqkuptuar tarifa e disa taksave te bizneset, por në përgjithësi nuk ka pasur rritje të taksave te asnjë biznes. Ne e kemi kaluar në Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe KPF dhe ka pasur harmonizim të çmimit të disa taksave.

P.sh te telefonja mobile IPKO ka qenë 200 euro taksa, është një kompani e madhe dhe në krahasim me postën ka qenë dallimi 5 fish. Tash e kemi taksuar me 1 mijë euro Zmobile, Ipikon dhe Kujtesën. Te sigurimi ndoshta nuk e keni vërejt, sepse nuk është 300 euro, por është 800 euro. Gjithashtu edhe te filialet e sigurimeve të bankave është 800 euro sikur te sigurimet. Mirëpo te njësitë e tyre që kanë zyre të vogla te bankat është 400 euro, kurse te sigurimet 300 euro. Kështu ka qenë edhe vitin e kaluar dhe nuk ka pasur ndryshim.

Sokol Haziri- një sqarim që e kërkuam ende nuk u dha i cili është aspekt përmbajtjesor i kësaj rregulloreje veprimi retroaktiv për 2013. Nuk ka nevojë të jetë 2013 ajo është shumë e qartë, veprimi retroaktiv nuk duhet të kufizohet.

Hevzi Matoshi- shumë gjëra të cilat i kisha ndërmend për t' i thënë u thanë, por veprimin retroaktiv e përmenda për shkak se pat vërejtje pse rregullorja nuk është miratuar me kohë?

Arsyeje ka qenë shumë e thjeshtë, sepse KK i ka mbajtur 14 mbledhje, mirëpo për shkak të ngarkesave që i ka pasur nuk ka mundur dy muajt e fundit të procedojë edhe me këtë rregullore dhe pse të gjitha procedurat paraprake kanë qenë të kryera.

E përmenda fuqinë retroaktive, sepse është fjala për muajin janar të vitit 2013, për arsye se i kemi disa kontrata si te shërbimet publike të cilat duhet të vazhdojnë. Për shkak që ato duhet të vazhdojnë është në vakum ligjor, sepse rregullorja po miratohet me 30 janar. Tash

me 1 janar nuk ka kurrfarë efekti tjetër veprues përpos mbulimi i kësaj zbrazëtie juridike në muajin janar. Lidhur me komisionet është e vërtetë se ka punuar, por për të vazhduar punën për vitin 2013 duhet të shikohet edhe dizajnimin i numrit të atij komisioni, mandej kemi vërejtje se përfaqësimi gjinor nuk është përfill. Për këtë arsyeje derisa nuk bëhet një dizajnim i atij komisioni, unë nuk kam të drejtë që ta thërras për ta filluar punën.

Leonore Bunjaku- unë po flas në emër timin, por e gëzoj këtë të drejtë edhe në emër të grupit nuk jam për pengimin e mbarëvajtjes së proceseve të nxjerra nga Ansambleja Komunale. Sa i përket akrobllëkut, Gjilani është i vogël dhe po thajse të gjithë do të dilnim fare fis, por ne jemi zëri i qytetarëve, kurse ju mbetet juve ta vlerësoni. Mos të keqkuptohemi se nuk jemi për pengim të mbarëvajtjes së proceseve.

Izmi Zeka- të mos keqkuptohemi, dy herë për një çështje askush nuk mund ta merr fjalën, sepse këtu nuk është treg.

Sokol Haziri- unë po kërkoj për ta sqaruar pozicionin tim se çka kërkoja dhe kërkoja qartë jo taksat që u kërkuar që të kenë veprim retroaktiv, por të liruaret, bizneset e liruara nga taksat, sepse ka pasur mundësi dikush të mbes borxh 5 apo 10 euro etj. Këto gjëra duhet t' i ketë çdo ligj i mëvonshëm, më i favorshëm për palën është ai i aplikuar jo ai i vjetri që ka qenë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi propozoi që të aprovohet pika 2/3 e rendit të punës, me vërejtjet që u bënë.

Aprovohet pika 2/3 e rendit të punës: Propozim rregullorja për taksat, ngarkesat dhe gjokat komunale për vitin 2013, me 33 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte kundër

2/4. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2012,

Izmi Zeka- raportin e kryetarit e kemi kaluar edhe në KPF, por së pari një njoftim për LDK-në se jemi marrë vesh me kryetarin që në shpejtësi do ta bëjmë një ftesë për kuotim për TV-të, radiot lokale për transmetim të seancave të Kuvendit.

Çështje tjetër është ajo që u tha për faqen e Komunës, duhet ta dini se ajo është faqe zyrtare e cila i paraqet aspektet zyrtare të Komunës dhe jo prononcimet e partive politike, as PDK-së, as LDK-së dhe të asnjë formacioni tjetër.

Gjithashtu para se ta merr kryetari fjalën, unë po ia lë vendin zv/kryesuesit, Selim Selimi që ta udhëheq këtë seancë, sepse më duhet të shkoj në takime të tjera në ministri.

Kryesuesi ia bartë fjalën, kryetarit të Komunës, z. Qemajl Mustafa.

Qemajl Mustafa- sa për fillim po iu njoftoj se më herët i kemi dërguar raportet e drejtorive në mënyrë që të ketë material të mjaftueshëm për ju dhe anëtarët e Kuvendit. Nëse dikush dëshiron për të parë se si ka funksionuar Administrata, Arsimi ose secili sektor gjatë vitit do të duhej për ta analizuar më ngadalë. Unë e kam përmbledh punën e vitit 2012 për të qenë një raport informativ për anëtarët e këtij të Kuvendit, por të mos mbetet vetëm në këtë

informatë të cilën unë e kam hartuar dhe ai që dëshiron mund të lexojë më shumë dhe le të japin kritika normalisht. Ka vend për t' u kritikuar dhe për të propozuar se si duhet të jetë ndryshe në vitin të cilin e kemi filluar.

Në përgjithësi është punuar mirë, është punuar me stabilitet, me klimë të mirë politike me marrëdhënie të mira ndër njerëzore dhe ndër etnike në Komunë.

Kjo është ajo që duhet theksuar në mënyrë të veçantë, ambienti ka qenë i sigurt, falënderuar të gjithë neve, falënderuar Policinë e Kosovës, KFOR-in, falënderuar OSB-në e cila e bën një kontribut të jashtëzakonshëm në marrëdhëniet që i ka me të gjithë sektorët e Komunës.

Komuna vazhdon t' i ruajë marrëdhëniet e mira me të gjithë, përbrenda Komunës dhe me institucionet e tjera tonat dhe me faktorin ndërkombëtar që është i vendosur në Komunë e sidomos me donatorët edhe investitorët. Për këtë arsyeje kemi edhe shumë dhurues dhe investitorë privat të cilët i kemi inakujtuar dhe na kanë ardhur në Komunë dhe kemi hyrë në një cikël të marrjes së investimeve të zhvillimi të hapjes së vendeve të punës e që janë disa qindra. Komuna është aktive në përfaqësim të interesave të sajë dhe jemi anëtar aktiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe jemi Anëtarë i Bordit dhe e japim kontributin tonë me tërë kapacitetin dhe dinjitetshëm dhe në vitin 2012 kemi qenë edhe anëtarë të Komisionit të Grandeve. Këtë ndoshta e keni dëgjuar se unë jam njeriu i vetëm që nuk e kam votuar formulën e grandeve për ndarje buxhetore nëpër komuna. Kjo është bërë me ngut nuk është marrë parasysh analiza që e kemi bërë në si komuna, përgjithësisht dhe sidomos Komuna e Gjilanit nuk jemi respektuar posaçërisht në nevojat që i ka arsimi dhe shëndetësia, por edhe administrata për shkak se komunat janë rrit shumë këtyre viteve, sepse ka ndodhur kthesë e madhe në investime dhe këto investime si pasojë kërkojnë mjete të tjera financiare, sepse duhet mirëmbajtje e shkollave, rrugëve, ndriçimit publik, sipërfaqeve të gjelbra dhe çdo gjë tjetër që kemi investuar në Komunë.

Sido që të jetë siguria, klima e mirë politike marrëdhëniet e mira që janë parakusht për zhvillim kanë qenë ato të cilat kanë bërë që Komuna të operojë mirë dhe të shpallemi prapë në shumë fusha të jetës komuna më e mirë në dhënien e shërbimeve edhe në kuptim të sasisë dhe të kualitetit.

Në fillim të fjalës së tij kryetari në formë të sllajdeve i dha të gjitha sqarimet për secilën drejtori veç e veç të cilin material anëtarët e Kuvendit e kanë në materialet e tyre për seancë. Elaborimi i kryetarit për zhvillimet në Komunë dhe për ndonjë sfidë që ka pasur zgjati afër dy orë.

Në fund të elaborimit kryetari i falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe theksoi se e pres kontributin e juaj në këtë Kuvend.

Selim Selimi- pas përfundimit të raportit të kryetarit për vitin 2012, fillimisht fjalën do ta kenë shefat e grupeve parlamentare, pasta sipas radhës edhe anëtarët e tjerë të Kuvendit

Sadudin Berisha- unë i falënderoj për fjalën e dhënë, por po theksoj se 1 orë e 40 minuta e kemi dëgjuar raportin e kryetarit me shumë durim për të marrë informacione të dorës së parë lidhur me atë që ka ndodhur në vitin e shkuar kalendarik. Mirëpo në raport është bërë një rishkrim nga dita e parë e mandatit të dytë të kryetarit të Komunës deri tek ajo se çka do të ndodh deri në fund të viti vitit 2013. Nëse me vëmendje e kemi dëgjuar dhe me siguri se po dhe nga ajo që e kemi këtu në pjesën dërmuese të këtyre fletëve të cilat na janë përcjell nuk ka të bëjë me përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat të cilat i ka kryetari i Komunës,

drejtoritë dhe Kuvendi i Komunës për të gjitha ato që janë të precizuara në LVL në Ligjin për financat komunale dhe ligjeve tjera sistemo që janë në përgjegjësinë dhe kompetencat e KK-së. Thjeshtë kemi të bëjmë me një frazë të përsëritjes së fjalimit nga vitit në vit dhe asgjë më shumë. Unë kërkoj që edhe opozita, por edhe pozita le ta theksojë vetëm një të arritur konkrete që u tha nga kryetari i Komunës që ka ndodhur gjatë vitit 2012! Vetëm një rast që e mbani në mend për 1 orë e 40 minuta se ka ndodhur një e arritur në vitin 2012! Sigurisht jo ?

Me shumë dëshirë unë dhe të gjithë do të dëshironim ta dëgjonim. Nuk mund të vlerësohet një punë efektive një punë e përditshme siç është administrata. Ajo është në shërbim të qytetarëve, është punë rutinore, mund të ngritën kapacitet për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve, por theksoma një të arritur? Drejtoria e Arsimit merret më tepër me rezultatin e nxënësve se sa na ofruan një informacion, një raport se çfarë janë ofruar dhe cilat janë kapacitet infrastrukture në arsimin e Gjilanit? Cili është ndryshimi në mes vitit 2011 dhe vitit 2012? A kemi zvogëlim të numrit të nxënësve nëpër klasë? A kemi rritje të kualitetit të infrastrukturës përgjithësisht ? Nuk e dëgjuam, sepse nuk ka pasur! Të vetmen shkollë e cila u përmend e cila ende nuk është në shfrytëzim është Shkolla e Bujqësisë e që është një investim i jashtëm. Nuk u përmend pse po ndodhin dështimet investuese të huajat? Gjimnazi sot e asaj dite mbetet objekt në ndërtim të vrazhdët. Biblioteka Regjionale që po flasim sot e asaj dite mbetet një fillim i ndërtimit të vrazhdët. Kujtoj se raporti i punës ka bërë vetëm një përshkrim të punëve të përditshme! Çka iu është ofruar kulturës, rinisë dhe sportit ? Cila është infrastruktura dhe gjendja e tyre? Cila është infrastruktura e shërbimeve në fushën e shëndetësisë? Për derisa ne i japim hapësirat publike për interesa private biznesore sot ne si qytetarë të Komunës së Gjilanit, nesër do të jemi të dënuar si strukturë politike se hapësirat brenda qytetit nuk ekzistojnë për të ndërtuar edhe një qendër të Mjekësisë Familjare apo një përfaqësim të saj kudo brenda qytetit, sepse këto nuk ndërtohen në periferi. Çka iu është ofruar rinisë? A kemi infrastrukturë shtesë që nga viti i shkuar, por edhe që para dy viteve?

A është ofruar një hapësirë për t' i zhvilluar aktivitetet e rinisë, qoftë të mbuluara apo të hapura. Nuk kemi raste të tilla! Ju lutem këto janë kompetencat e drejtorisë për të bërë dhe ofruar projekte. Këto janë përgjegjësitë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe gjithnjë kryetarit, sepse këto janë nën mbikëqyrje e tij. Ne kemi dhënë hapësira për ndërtim të objekteve të larta pa asnjë interes publik dhe thirrje se prej tyre do të inkasojmë tatime, taksa etj. Ky nuk është zhvillim ekonomik nëse e marrim për interesa publike. Unë mendoj se nuk duhet lejuar përsëritjen e retorikës së vazhdueshme. Kjo qeverisje është viti i fundit kur do të duhej të finalizoheshin obligimet e tyre. Janë premtuar së paku 3 raste me katër korsi në drejtim të Gjilanit Asnjë nuk ka ndodhur dhe nuk ka gjasa reale për të hyrë në një investim si: drejtimi Prishtinë – Gjilan, drejtimi Bujanoc- Gjilan dhe drejtimi, Ferizaj –Gjilan.

Gjilani ka mbetë kancer i investimeve kapitale nga Qeveria për shkak të përformancës së dobët të qeverisjes komunale. Këtë duhet qartë ta themi dhe nuk është e ndershme dhe e mirë që 1 orë e 40 minuta të merret kohë këshilltarëve dhe atyre t' epet një hapësirë simbolike për t' lodhur dhe për të kaluar raporti i punës sa për ta aprovuar.

Edhe një vërejtje sërish kryetari thotë se kjo është miratuar në KPF. Ky raport nuk është miratuar, raporti është paraqit si nevojë për t' u paraqit si pikë e rendit të punës në seancën vijuese. Më habit fakti ku në pjesën e diskutimit të tij e thotë këshillat nuk janë themeluar? Të gjithë e dimë e kemi marrë një vendim e kemi hartuar një rregullore dhe kemi krijuar mundësinë më të mirë në mes Qeverisë komunale dhe këshillave për interesin e qytetarëve lokal dhe thotë megjithatë kanë funksionuar! Kush ka funksionuar? Është shumë jo

originale e shkruar dhe e thotë : nuk janë themeluar, megjithatë janë themeluar! Për atë arsye po them t' i ikim retorikës. Unë jam i bindur sikur të kishte pasur rezultate konkrete gjatë vitit 2012 me 20 minuta do të furnizoheshim me informacione të bollshme. Unë kërkoj falje që jam kaq i drejtpërdrejtë, por nuk duhet t' i vëmë vetes maskë! Pjesën dërmuese të fjalës është thënë do ta bëjmë, është bërë etj.

Sido që të jetë për pjesët më detale të fushës së arsimit, kulturës dhe rinisë, të shëndetësisë që janë më të ndjeshme, sepse aty gravitojnë interesat e çdo qytetari do të kenë fjalën ata që janë më afër problemeve për të mos marrë unë monopolin si përfaqësues, sepse janë autonom në gjykimet e tyre.

Qemajl Mustafa- vetëm pak desha ta orientoj bisedën dhe mos flisni pa saktësi! Të gjithë këshilltarët e dinë që KPF e rekomandon me shumicë votash për Kuvend. Mos manipulo dhe mos fyej gjithashtu, kur thua nuk keni kapacitete! Unë do të tregoj kur ta marrë fjalën se sa ka kapacitete Komuna dhe që nuk kam pasur mundësi t' i përmendi ato kapacitete në një raport kaq përmbledhës dhe e kam thënë raport përmbledhës dhe të shkurtër. Kur e marrë fjalën të tregoj, por kur ta merrni fjalën të jeni korret së paku politikisht. Mos fyei dhe e dyta mos pretendoni që këta 40 të tjerë që janë ulur së bashku me Sadudinin nuk i dinë procedurat.? I dinë fortë mirë. Komiteti nuk merr vendim për raportin, por ka debatuar dhe e kemi rekomanduar me shumicë të votave.

Sokol Haziri- unë e falënderoj kryetarin për angazhimin e tij dhe për paraqitje e tij para këshilltarëve. Është e vërtetë janë bërë punë dhe mund të bëhen punë edhe më tepër dhe ne e kemi thënë edhe në KPF ku e kemi rekomanduar raportin e kryetarit për Kuvend. Kjo nuk ka dilemë, ne nuk kemi marrë vendime, por e kemi rekomanduar për Kuvend, ku do t' i paraqet secili këshilltarë pikëpamjet e veta dhe gjykimet e tij lidhur me raportin e punës dhe rezultatet e punës së kryetarit.

Duhet të jemi vigjilent që këtë debat mos ta përdorim si fushatë politike, sepse ende jemi larg prej zgjedhjeve, por të fokusohemi në probleme kryesore të qytetarëve për të cilat ishin disa elemente, por jo të mjaftueshme që të precizohen qartë se cilat janë ato të arritura dhe të ndjeshmërisë që e ka qytetari ndaj asaj të arriture.

Unë vërejtje kam thënë edhe në KPF dhe po e përsëris se ndoshta shtrirja nuk ka qenë e duhur sa i përket investimeve, sepse ka zona në të cilat nuk është investuar asgjë në asnjë pushtet. Vërejtja e ime qëndron në këtë që në përdhën e ardhshme duhet t' i kushtohet kujdes i shtuar edhe këtyre zonave, sepse edhe ata janë qytetarë tanë.

E dyta ka të arritura në shumë sektor si në arsim, por ka shumë punë për t' u bërë, ka zhvillime pozitive, por ka edhe zhvillime negative që definitivisht meritojnë gjykim.

Pasi që është drejtori i Arsimit po e shfrytëzoj rastin për ta thënë një çështje. Organizmi i ekskursioneve ilegale që po ndodhin (është rasti i fundit i rrokullisjes së autobusit në Shterpcë) për këtë çështje z, drejtor është një dështim i llojit të veçantë, sepse keni përgjegjësi objektive për çfarë do që ndodh në shkollë! Çdo kush që merr veprime të tilla pa harmonizim të shkollës dhe DA-së është përgjegjësi direkte e drejtorit të Arsimit dhe e kryetarit. Këto gjëra nuk guxojnë më të ndodhin dhe duhet të nxirrin një urdhër që gjëra të tilla më nuk guxojnë të ndodhin. Nuk dua të elaboroj shumë, por po them se ka ngecje në kuptimin infrastrukturor, por një gjë dua ta them qartë, ne duhet të jemi real dhe korrekt dhe në bazë të kapacitete financiare që i kemi duhet pritur edhe zhvillimin. Unë jetoj në

Gjilan dhe edhe pse PDK-ja është në pushtet, dëshiroj që këta të punojnë mirë dhe të krijojmë kushte për zhvillim për qytetarët tanë.

Te çështja e punësimit sinqerisht do të dëshiroja që të ishte ashtu dhe të mbyllet kapitulli i punësimeve politike. Do dëshiroj që të ishte ashtu, sepse qytetarët janë të barabartë, pa marrë parasysh a është i PDK-së, AAK-së, LDK-së dhe secili të trajtohet si qytetarë i Gjilanit, sepse edhe kryetari është kryetar i të gjithë qytetarëve të Gjilanit.

Arben Maliqi- fillimisht duhet të përshëndetet ky raport i kryetarit dhe ne si grup i AKR-së e kemi analizuar mirë dhe kemi konstatuar se është një raport i mirëfilltë konciz dhe i qartë.

Mirëpo nuk duhet menduar se nuk ka vërejtje nuk ka gabime, sepse njerëzit të cilët punojnë edhe gabojnë. Unë mendoj se është bërë një punë e përkushtuar, konformë mundësive dhe kapaciteteve që ka pasur Komuna, por ndoshta edhe janë tejkaluar disa mundësi dhe janë bërë disa punë të cilat nuk kemi pasur mundësi t' i mbulojmë, mirëpo i kemi bërë për të mirë të qytetarëve. Sa i përket këshilltarëve të kryetarit, gjegjësisht drejtorëve duhet kuptuar se të gjitha drejtoritë nuk kanë mundur ta bëjnë punën ashtu siç duhet, sepse për të qenë menaxher është një punë e vështirë dhe nuk mund të gjithë të jenë menaxher të mirë. Mund të jenë profesionalistë dhe ekspertë të mirë, por jo edhe menaxher të mirë. Mirëpo ka edhe disa specifika dhe janë disa drejtori të cilat me të vërtetë kanë probleme.

Në përgjithësi është bërë një punë e mirë dhe një angazhim i duhur. Mandej është e vërtetë se është një klimë e mirë në për të cilin klimë, më i merituari është kryetari. Sa i përket zyrave, ato e kanë kryer punën e vetë dhe ishte shumë mirë nga ana e kryetarit i cili e përmendi Zyrën e Auditimit, të cilën ne nuk e kemi përmend në asnjë rast, por z. Sherafedin Latifi e bën një punë të mrekullueshme dhe na i dokumenton gabimet tona për të qenë më të kujdesshëm për herët e tjera. Unë si gjithëherë kontributin tim mundohem t' ia jap më së shumti arsimit.

Në sferën e arsimit, drejtori e bën një punë të madhe dhe e dimë se arsimi është një fushë e gjerë dhe është një mal me probleme. Në arsim duhet të kemi shumë kujdes dhe dëshira e ime për vitin 2013, do të ishte që arsimi të jetë i depolitizuar, sepse aty janë votat e shumicës së qytetarëve. Është mirë që si menaxher të vendosen njerëz të cilët dinë për ta udhëhequr dhe të cilët në çdo aspekt janë të formuar si në atë moral, patriotik etj.

Në arsim janë bërë disa lëvizje të mira, numri i nxënësve nëpër klasë është zvogëluar, janë ndërtuar shkolla si për arsim fillor ashtu edhe për të mesëm. Mirëpo unë si gjithëherë që kam kërkuar edhe njëherë e kam të njëjtën kërkesë që shkollat të jenë të pajisura me kabinete, të kompletuara me salla të edukatës fizike dhe me komplekse sportive.

Janë ndërtuar disa shkolla dhe asnjëra prej tyre nuk ka sallë të edukatës fizike. Në fillim duhet menduar mirë dhe duhet planifikuar dhe ndarë buxhet edhe për ndërtim të sallave.

Sa i përket shkollimit të mesëm u përmend "Danida" e cila është një dhurues shumë i madhe dhe e ka ndërtuar një shkollë së cilës ia kanë lakmi të gjithë. Mirëpo shtrohet pyetja se kush do të shkojë në atë shkollë? Unë po i pyes këtu të gjithë ne që jemi këtu a e dërgon dikush fëmijën e vet në shkollë të bujqësisë? Unë jam shumë i bindur se askush nuk e dërgon në bujqësi fëmijën e vetë. Duhet të kemi kujdes dhe mos ta rrisim numrin në Gjimnaz dhe Mjekës, sepse është një shkollë që ia vlen. Bujqësia është prioritet, por është mirë t' i ndërtojmë emrin kësaj shkolle. T' ia vëmë një emër tjetër dhe t' i hapim disa profile të tjera, sepse kjo shkollë është e përsosur.

Sa i përket kulturës, sportit është e vërtetë se janë bërë shumë arritje dhe na ka mbetur edhe një fushë te varrezat e cila do ta ndihmojë shumë sportin gjilanas, por është mirë që të

çaktojmë edhe vende të tjera për komplekse sportive. Rininë tonë duhet fokusuar në sporte, sepse nëse rininë tonë e largojmë prej lokaleve të mbyllura dhe dalin në komplekse sportive është sukses i madh. Drejtori i bujqësisë e ka bërë një punë të mirë, sepse ka pasur shkatërrim dhe prerje të drunjve tej mase, është arrit të zvogëlohet kjo dukuri, por prapëse prapë kemi shkatërrim e sidomos të faunës. Unë kam qenë në këtë komision, tri shoqata janë dhe po shkatërrohet fauna, po gjuhen kaprojtë. Është mirë me një angazhim të madh të të gjithë neve që kësaj dukurie t' i themi stop.

Edhe një gjë kërkoj që në shkollat e mesme dhe ato fillore edhe 13 vjet pas luftës kemi trauma të ndryshme të fëmijëve tanë, prandaj nëpër shkolla me numër të madh të nxënësve t' i fusim edhe psikologët. Kemi fëmijë të retarduar, të divorcuar dhe aty shprehen manifestimet e tyre dhe traumat psikike.

Në fund e lus kryetarin e Komunës që projektet të cilat janë të pambaruara, konkretisht fshati im Kosaq mundësisht që rrugën ta asfaltojmë. Ju faleminderit për durim.

Ejup Haziri- sa për fillim, po e theksoj se Arbeni e bërë një gabim gjatë fjalës së tij, sepse nuk ka fëmijë të divorcuar, por ka bashkëshortë të tillë.

Sa i përket raportit e mbështesim i cili është një raport për një periudhë kohore dhe për secilën periudhë kohore i kemi dy segmente. E kemi të dëshirueshmen dhe të mundshmen.

Duke u bazuar në të mundshmen ne besojmë se kryetari e ka bërë më së miri atë ka pasur mundësi për ta bërë. Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështet raportin dhe me qëllim për të lënë hapësirë më tepër të tjerëve 9 minuta po i fali.

Leonorë Bunjaku- edhe ne grupi i këshilltarëve të G-3 e mbështesim raportin e kryetarit së bashku me punën e drejtorive të Komunës së Gjiçanit. Mirëpo unë po ndalem pak te çështja e arsimit, sepse ngritja e vazhdueshme profesionale në arsim duhet të ndodh në vazhdimësi. Duhet të organizohen trajnime të cilat njëherë fillojnë, por më vonë për shkak të buxhetit, apo arsyeve të tjera nuk vazhdojnë ato. Një çështje tjetër e cila më brengos, sepse jam edhe kujdestare e një klase në Gjimnaz ku nuk ecin punët ashtu si duhet. Duhet të jemi pak më autoritativ në thyerjen e notës sa i përket disiplinës dhe atyre që bëjnë probleme vazhdimisht të merret dikush më shumë me ata, por u tha se ne moti e kemi kërkuar një psikolog në shkollë dhe të merret me ata nxënës problematik. Duhet të merren masa më të hollësishme me këta nxënës.

Rashit Sahiti – unë jam punëtor i arsimit dhe do të flas për këtë sferë më tepër. Unë për drejtorin i kam edhe disa pyetje dhe disa komente. Së pari sa punëtorë DA i ka pranuar në këtë vit shkollor pa konkurs? Unë e di se ai do të ma jep një përgjigje dhe tjetërkush do të mundohet ta arsyetojë, por po them paraprakisht se duhet të ketë konkurse edhe plotësuese edhe të jashtëzakonshme etj. Në asnjë mënyrë t' i dërgojmë në punë dhe t' i lëmë një vit aty punëtorët pa konkurs.

Gjithashtu pyetja tjetër është se nëpër listat e pagave të shkollave a figurojnë edhe emra të punëtorëve që nuk janë punëtorë fare në atë shkollë? Unë e di që ka të tillë dhe në shkollën ku punoj unë janë 4 që nuk i njeh askush ku janë? Punojnë diku, por nuk dihet ku?

Në këtë mënyrë dëmtohet buxheti i shkollës sonë.

E kam lexuar raportin e DA-së e analizova dhe më brengosi fakti se në nivelin 1 dhe 2, 26 nxënës janë të pavlerësuar, kurse në nivelin 3 janë 57 e që gjithsej bëjnë 83 nxënës të zbërthyer në klasë na mungojnë 4 klasë.

E kam edhe një pyetje tjetër për drejtorin e Arsimit se a ka informacion për punëtorët që pas licencimit janë zbuluar se kanë dokumente ose diploma false dhe ndaj të cilëve është ngrit procedurë penale. Nëse ka informacion, çka është ndërmarrë? A janë suspenduar ata mësimdhënës? Në fillim të vitit shkollor për çdo shkollë ndahet buxheti, ndërsa më vonë diskutohet buxheti për shkolla që iu ndahet në fillim. Bie fjala në Shkollën Teknike iu është shkurtuar buxheti për 50 mijë euro. Në këtë mënyrë paraqiten pengesa për zhvillim normal të mësimin, sepse ose mungojnë lëndët djegëse, ose pajisjet për ndonjë kabinet dhe mjete të tjera konkretizimi. Është edhe një brengë tjetër, sepse në Shkollën Teknike, organizohet mësimi jo formal dhe kjo shkollë prej atyre mjeteve që i inkason nga kandidatët e këtij mësimi i ka dorëzuar Komunës 10 mijë euro, ndërkaq Komuna e dinë që ata punëtorë punojnë me pagesë, sepse e kanë mbajtur mësimin jashtë orarit të punës dhe afër 4 mijë euro duhet t' i kthehen. Është domosdoshmëri hartimi i rregullores së brendshme të shkollave që e përmendi më herët që e përmendi kolegja për evitimin e dukurive negative mungesa etj.

Një klasë në shkollën time i ka 857 mungesa, kurse numri i nxënësve për klasë është 20.

Kujdestari, drejtori nuk janë në gjendje që të marrin masa disiplinore ndaj atyre nxënësve të cilët e kanë një numër aq të madh të mungesave. Unë kërkoj që të decentralizohen ose të delegohen kompetencat nga DA nëpër drejtorin të shkollave në mënyrë që ato t' i kenë duart e lira për veprim të mëtijmë që i përcakton ligji.

Në raport na mungojnë orët e humbura të mësimdhënësve, nuk është paraqitur kush ka munguar, sepse kemi njohuri që ka mësimdhënës që nuk ka mbajtur 3 muaj fare mësim, por nuk e di a është i njoftuar drejtori? Nuk e di është ndërmarrë diçka ndaj tyre, por unë e di që ai person përsëri figuron në regjistrin e pagave. Në këtë Kuvend kryetari e pat dhënë një premtim se do t' i luftojë postet e dyfishta, vendet e punës të dyfishta, por nuk e di është ndërmarrë diçka në këtë drejtim? Unë e di që ende ka njerëz të cilët punojnë në dy vende dhe i realizojnë nga dy paga. Ndërsa e përgëzoj Zyrën e Inspeksionit të Arsimit, respektivisht sektorin e licencimit që nga Ministria është shpallë ndër më të suksesshmet në Kosovë, sepse e ka bërë përgatitjen e dokumentacionit dhe së shpejti brenda 10 dite do të licencohen punëtorët e Komunës sonë. Sigurimi është një defekt i madh nëpër shkollat tona dhe është folur mjaft për rrethimin e kompleksit të shkollave, por ende nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim. Ne po kërkojmë reforma, por nëpër shkolla tona mungon inventari dhe disa shkolla na përngjajnë sikur të shek. XVIII. Urdhëroni nga ky vend dhe vizitoni shkollën e Pogradit, fatkeqësi e madhe, asnjë karrige në sallën e arsimtarëve, nuk ka fare inventar në atë shkollë. Gjithashtu para fillimit të viti shkollor ka pas premtuar se numri i nxënësve nëpër klasë nuk do të tejkalojë atë që është paraparë me ligj 32 nxënës. Shkoni në Gjimnaz, Mjekësi e shihni sa është numri! Gjithashtu edhe për ndërrime u patëm lavdëruar moti dhe kemi thënë nuk do të ketë tri ndërrime dhe do të zhvillohet mësimi normalisht, por ora 30 minuta nuk po hiqet.

Mirëpo është edhe një plagë tjetër e ajo është organizmi i kurseve private të cilët arsimtarë mbajnë mësim me të njëjtit nxënës. Ata i kushtëzojnë nxënësit për të shkuar në kurse, nëse nuk shkojnë ia japin notën e dobët dhe ai nxënës pëson. Iu faleminderit për durim, kam edhe më tepër, por me këto vërejtje po e përmbyll.

Arianit Sllamniku- unë po e filloj këtë debat duke i pasur parasysh e “kritikat” e mia të cilat disa m’ i kanë konsideruar si personale, por unë i falënderoj edhe për korrektësi duke filluar nga kryetari, drejtorët etj.

Unë do t'ia filloj prej administratës publike e cila së pari duhet të jetë një institucion apolitik, e që njihet si sukses i qeverisjes komunale. Administrata duhet të funksionojë edhe sikur fushatat zgjedhore të zgjasin edhe 3 deri në 4 muaj. Unë mendoj se nuk është ndonjë e arritur nëse thuhet ristrukturimi ose reformimi, sepse administrata është administratë.

Aty është vetëm një veçori që kemi pasur shtesë të numrit të kontratave në vepër, kurse digjitalizimi duhet të jetë prioritet nuk duhet të merret ajo si e arritur edhe shumë e madhe.

Në listën e USAID-it të datës 2.3.2009, unë nuk mendoj që është një normalitet i mbarëvajtjes së punëve. Kryetari përmendi Hani i Elezit me 16 biznese dhe një administratë të vogël, kurse Komunën e Gjilanit e pamë te raporti i drejtorisë së re të Zhvillimit Ekonomik rreth 1 mijë biznese, por që administrata e Gjilanit është dukshëm më e madhe se ajo e Hanit të Elezit, kështu që ecuria do të duhej të jetë e njëjtë. Janë edhe parametrat tjerë të cilat e karakterizojnë me USAID, Komunën.

Te Drejtoria e Inspeksionit unë edhe prej vitit 2009 përmes shkrimeve të mia publike, opinioneve e kam dhënë mendimin që kategorik që të mbyllet tregu afër Kishës Ortodokse.

Mirëpo asnjë institucion këtë punë nuk e ka marrë me seriozitet. E kanë quajtur mendim nacionalist e të thëna të tjera, por edhe kam pasur edhe takime me ndërkombëtarët për këto opinione. Unë edhe përkundër presioneve, përsëri këtë qëndrim timin e mbështesë deri në fund. Efekti i një tregu ilegal ku Inspeksioni nuk ka qasje dhe punohet pa asnjë kontroll dhe leje ajo është kërcënim për konsumatorët e kësaj Komune. Nuk dihet cilësia e artikujve të cilat shiten në atë treg! Çka do të ndodh nëse na vije ndonjë epidemi nga këta artikuj? Kush e ka përgjegjësinë? Në këtë jam kategorik dhe vazhdimisht po e përmendi që nga viti 2010. Te Drejtoria e Inspeksionit u tha se janë inspektorët e veterinës, ushqimit, ambientit etj. Mirëpo të ambientit asgjë nuk pamë dhe pikërisht te kjo drejtori dhe te ky segment po ndalem, sepse teoria e një analize dhe raporti të mirë për një drejtori 12 mujore për mua është banale për të qenë e përfshirë në 4-5 faqe A-4. Edhe Monografia na është bërë një përrallë pa referenca. Monografia e një qyteti po na del me 5 -6 referenca në fund.

Përsëri po kthehem te ambienti, sepse kemi pasur ngordhjen masive të florës dhe faunës në vitin 2011 dhe atë pikërisht peshkut në lumenjtë e kësaj Komune. Kam pritur të paktën në media ose në ndonjë prononcim që të del drejtoria ose Komuna me një raport të detajuar për atë dukuri për të cilin rast ka qenë i informuar edhe Agjensioni Ushqimor i Veterinës që ka lidhje të drejtpërdrejtë me Zyrën e Kryeministrit.

Te Drejtoria e Arsimit fal zotit që kemi ardhur me një infrastrukturë të rregulluar shkollore në objekte të reja, por mua më intereson se këto objekte të reja a kanë leje ndërtimi? Unë e di jo zyrtarisht se disa objekte shkollore të reja nuk kanë as leje ndërtimi. Do të duhej të ishte një miratim i nivelit komunal për një ndërtim të tillë. Te sfidat e arsimit dhe problemet unë nuk e pashë asnjë fjali ku u përmenden problemet dhe sfidat e arsimit për vitin 2012. U falënderuan ata që duhet të falënderohen, Zyra e kryetarit, OSB-së DANIDA, por edhe një polic i Kosovës. A mos është ai polic i cili konfiskoi narkotik në Shkollën "Selami Hallaçi"? Është mirë t'ia shkruhet edhe emri!

Te Urbanizmi në këtë Kuvend e kam ngrit çështjen e ndërtimeve të cilat janë bërë në Komunën tonë për ndërtime të reja afaristo-banesore, por unë e kam një pyetje se ai i plotësojnë kriteret për banim këto ndërtime të cilat janë bërë gjatë viti 2011-2012?

Sa i përket Zyrës së Projekteve kjo zyre duhet të jetë më aktive, sepse nga fondet e BE-së janë kthyer mbrapshtë 427 milion euro si pasojë e mos shfrytëzimit e që janë të dedikuara për projekte në territorin e Kosovës. Unë desha vetëm ta di se Zyra e Projekteve në Gjilan sa projekte ka fituar nga BE-ja?

Abdyl Aliu- unë po e filloj këtë diskutim duke shpalosur një ves të keq të kësaj Qeverie Komonale nga i cili ves në asnjë mënyrë nuk po mund të heq dorë. Është viti i 4 me radhe dhe jo vetëm unë, por edhe kolegët e PDK-së janë për atë që raportet e drejtorive mos të shkojnë në KPF dhe këtu në Kuvend për pa kaluar në komitetet përkatëse.

Komitetet janë filtra në këtë aspekt dhe po të kishte ardhur në komiteti raporti i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, aty do t' i bëja vërejtjet drejtorit që t' i përmirësojnë gabimet në faqen e parë ku thotë raport për vitin 2013, do t' i them që ta shkruajë për vitin 2012.

Gjithashtu do t' i rekomandoja ku thotë drejtor i PZH-së, t' i shtojë edhe asaj drejtor i kompanisë së sigurimeve nuk e kam të qartë emrin.

E përgëzoj drejtorin dhe drejtorinë për ecjen në kohë, por sigurisht drejtori shikon filma fantastikë dhe është frymëzuar prej tyre dhe në bazë të frymëzimeve të tilla shkruan raporte që do të vijnë, do të thotë është raporti për vitin 2013.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik edhe pse do të duhej të kishte punë me shumë drejtori të tjera, në të vërtetë ka punë vetëm me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari, kurse shumë pak edhe me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik. Gjatë tërë viti vetëm njëherë jemi takuar me drejtorin për Zhvillim Ekonomik, kurse të dytën herë para një jave.

Raporti i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ka ardh në seancë, kurse drejtori për Bujqësi dhe Pylltari nuk ka sjell fare raport me arsyetim se nuk ka qenë i njoftuar për ditën kur do të mbajë seancën komiteti. Kjo për mua është një ikje nga shqyrtimi më i mirë dhe më detal i raporteve, kurse pse është kjo ikje le ta thonë vetë drejtorët.

Në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, nuk paraqitet një raport i mirëfilltë për faktin se është hera e parë që raporton për një periudhë njëvjeçare. Pasi që është hera e parë raporti do të duhej t' i përmbajë edhe disa elemente që i mungojnë si shembull do të duhej ta kishte një skemë organizative. Raporti nuk paraqet mangësi thuhet se drejtorja ka punuar mirë pa probleme, por nuk ka pasur planifikim të buxhetit dhe nuk ka pasur as staf të mjaftueshëm dhe për këtë arsyeje nuk i paraqet të metat e kësaj drejtorie. Përmendet PPP dhe taksat që janë realizuar në emër të tokës ndërtimore mjetet financiare të realizuara nga shitja e banesave dhe shitja e lokaleve. Nuk flitet për të këqijat që i ka sjell ky PPP dhe nuk thuhet se ky PPP në çfarë gjendje e ka sjell Drejtorinë e Kadastrit. Në këtë drejtori kam qenë një ditë dhe e kam pyetur veten a jam në institucion apo pishinë të brendshme!

Bahrie Veseli – ne e dëgjuam raportin e kryetarit dhe për një kohë të gjatë u ndal në disa gjëra të imta dhe me politikën e tij bëri që të lodhemi më shumë për të mos pasur mundësi që të japim shumë vërejtje. Unë më tepër po ndalem te DA, sepse dhe dje në mbledhje të komitetit i kemi theksuar disa mangësi në këtë raport.

Së pari në raport pjesa e kryesore është statistikë do të thotë vetëm numra, sa nxënës janë në nivelin e parë, sa në të dytin, tretin etj. Ne kemi kërkuar që të kemi një pasqyrë reale me mungesat e arsimtarëve (mungesat me arsye dhe pa arsye) dhe nuk e dimë pse për ato mungesa nuk bëhet zëvendësimi i punëtorëve kur ata mungojnë në mësim 2, 3 e më tepër javë? Në këtë mënyrë humbet një numër i madh i orëve mësimore.

Mandej një problem tjetër shqetësues i cili na preokupon të gjithë neve këtu është ajo për kurset private të cilat po mbahen nga arsimtarët me të njëjtën nxënës të cilëve edhe iu japin mësim. Në këtë mënyrë nuk po zbatohet ligji adekuat, sepse këtë e ndalon ligji!

Unë e di që DA e ka përkushtimin për punë, por e pyes drejtorin sa ka arrit që të krijojë kushte normale për procesin edukativo-arsimor ? Është një fakt i pamohueshëm se në asnjë

sallë të edukatës fizike nuk punohet asgjë dhe mungojnë mjetet e konkretizimit duke filluar nga topat e rekuizitat tjera sportive. Mirëpo kam njohuri që orët e edukatës fizike nuk mbahen në shumë shkolla dhe nuk dihet pse nuk mbahen, por edhe nuk është ndërmarrë asgjë ndaj atyre arsimtarëve. Disa punëtorë të vjetër teknik me përvojë të gjatë janë transferuar në kompani private të cilët nga 2-3 muaj nuk marrin paga. Të gjithë jemi familjar dhe e dimë se në çfarë kushte po jetojmë, prandaj nuk është mirë të dëgjoen këto probleme edhe më tej! Mandej kur flitet për numrin e nxënësve, 83 është numri i nxënësve të arsimit fillor e që janë 4 klasë, të klasat e dhjeta deri në të trembëdhjetat 107 nxënës janë përsëritës, 127 nxënës janë të pavlerësuar, por nuk janë dhënë arsyet pse ata nxënës nuk i vijojnë mësimet? Një problem tjetër është se nxënësit e shkollës në Zhegër janë në kushte ekstreme të rënda. Për këta nxënës në Zhegër e kam një kërkesë që drejtori dhe kryetari sa më parë të ndërmarrin diçka dhe t' i sjellim në qytet dhe mos t' i lëmë në ato kushte aq të rënda. Problemi tjetër shqetësues është dhuna nëpër shkolla të cilën dukuri nuk po mundemi për ta çrrënjësuar dhe me siguri drejtori ka njohuri për këtë dhe për këtë po krijohen probleme edhe prej prindërve.

Mimozë Shkodra- unë kam diçka lidhur me Drejtorinë e Bujqësisë edhe pse drejtori nuk qenka këtu, por i cili ka qenë desh të jetë patjetër këtu. Në raportin me shkrim janë të dhënat për projektet e realizuara, mirëpo unë kërkoj që ta di se kush janë përfituesit e këtyre mjeteve (të dihet me emër dhe mbiemër)? . Është mirë që të na dërgohen përmes adresës elektronike për seancën e ardhme. Për arsim ne i kemi shqetësimet tona si grup i AKR-së gjithmonë i japim në mbledhje të komiteti dhe këtu nuk po iu marrë kohë.

Mirëpo e kam një vërejtje për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që kur të mbahet “Flaka e Janarit “ është mirë që çdo anëtarë i Kuvendit ta ketë një ftesë ndoshta pak më të veçantë në krahasim me pjesën tjetër të qytetarëve. Kjo është një shqetësim shumë i madh, por edhe te partitë politike dhe është mirë që kjo vërejtje të ketë konsideratë. Mua më vjen keq, por kjo po më duket se është shqetësim për të gjithë ne që jemi këtu.

Jashar Jashari – e përshëndesim dhe e falënderojmë kryetarin për raportin e tij, por unë do të ndalem te raporti i Drejtorisë për Shëndetësi për vitin 2012. Ky raport mund të vlerësohet deri diku i mirë, por megjithatë ka pasur hapësirë që të jetë shumë më i mirë sikur të realizoheshin të gjitha projektet e planifikuara për vitin që shkoi. Në këtë raport të punës 1 vjeçare nuk kemi të dhëna mbi grupin punues të QKMF-së për kontrollimin sistematik të nxënësve të shkollave fillore në Komunën e Gjilanit. Unë jam kureshtar për ta ditur se cilat janë ato shkolla në të cilat është kryer kontrollimi sistematik i nxënësve? Cilat janë rezultatet e këtij projekti ? Sa është përqindja e kontrolluar deri më tani?. Mandej cilat janë sëmuret më të shpeshta të cilat janë zbuluar te këta nxënës fal këtij projekti?

Në kuadër të Drejtorisë e kemi edhe Zyrën për Ujë dhe Zyrën për Shëndet Publik.

Zyra për Ujë, thotë janë marrë mostra uji për hulumtim të ujit të pijshëm në objektet shkollore dhe ambulancave në zonat rurale. Unë e përshëndes këtë iniciativë të hulumtimit të ujit , por në raport nuk janë të dhënat se cili është rezultati i këtij hulumtimi? Kemi apo nuk kemi ujë të pijshëm? Janë marrë dhe hulumtuar mbi 40 mostra uji në 22 vendbanime rurale, por në raport nuk kemi të dhëna se për çfarë uji bëhet fjalë? Janë hulumtuar 5 mostra në Lagjen e Muhaxhirëve të Uglarit me kërkesë të fshatarëve (puse private), por unë besoj se këto mostra janë bërë, por iu mungojnë në raport dhe nuk thuhet është apo jo ky ujë i pijshëm?

Zyra për Shëndet Publik, nga monitorimi i sëmurjeve ngjitëse në zonat rurale, sipas raportit thuhet se ky monitorim është bërë në 8 fshatra, por cilat janë ato fshatra nuk i dimë, sepse nuk cekën fare. Nga ky monitorim, raporte të ngjashme të vitit 2012 e kemi shifrën totale për sëmurjet ngjitëse me 1324 raste të zbuluara. Cilat kanë qenë masat parandaluese nga Mjekësia primare për këtë shifër dhe pse nuk është bërë e ditur në këtë raport për cilat sëmurje ngjitëse është fjala?

Shërbimi i Vaksinimit është njësi që vepron në kuadër të QKMF-së dhe se kjo njësi është e detyruar sipas Ligjit për shëndetësi që të mos mbetet për pa u vaksinuar asnjë nxënës.

Raporti që na është ofruar në formë të tabelave është i mirë i punuar mirë, por jo i realizuar sipas planit! P.sh vaksinimi i fëmijëve me vaksinë DTPR + OPV shënon shifrën 71%, vaksinimi me vaksinën MMR arrin shifrën 82% dhe kështu me radhë për të gjitha llojet e vaksinimit. Për kundër asaj që raporti është bërë në fund të muajit nëntor, unë nuk konsideroj se kemi një raport efikas dhe solid, ashtu si do të duhej të ishte i publikuar para Kuvendit. Nuk është arrit të kryhet vaksinimi ashtu siç është planifikuar?

Në raport thuhet se në QKMF ka vështirësi, sepse ka numër të pamjaftueshëm të mjekëve dhe infermierëve, prandaj e pyes drejtorin sa mjekë dhe infermierë i ka pranuar në vitin 2012 dhe sa punëtorë të administratës? Pse nuk e mbulon Shërbimin e rëntgenit edhe me një punëtor teknik, sepse i njëjti iu mungon me vite? Mandej këtë shërbim e keni vetëm me një ndërrim dhe aq më keq kur punëtori i këtij shërbimi shkon në ndonjë pushim vjetor apo mjekësor ky shërbim mbyllet dhe qytetarët presin kot.

Shpresë Kurteshi- unë do të ndalem te DKRS dhe fillimisht po theksoj se në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport, raporti nuk ka pasur mundësi se si të kalojë, sepse nuk është sjell fare! Nuk është e çuditshme se pse përsëri ka ndodhur një gjë e tillë, sepse kjo është bërë tradicionale kjo formë e punës së kësaj drejtorie, duke injoruar komitetin.

Realisht kjo çështje më tepër duhet ta shqetësojë drejtorin, por nuk ka nevojë të shqetësohet për një fakt e që është se komiteti përbëhet prej anëtarëve shumicë të opozitës, sepse ne edhe ashtu jemi dhe do të vazhdojmë të jemi konstruktiv. Një fakt tjetër shqetësues është mos sjellja në komitet projekti i Flakës së Janarit 2013 dhe si komitet nuk kemi qenë të njoftuar për asgjë as para dhe as pas manifestimit të Flakës! Mirëpo ne po shpresojmë se me një të ardhme me një seriozitet më të madh komiteti do të njoftohet prej Drejtorisë dhe mos të injorohet deri në këtë masë.

Sa i përket këtij raporti, te Sektori i Rinisë konsideroj se është mjaft sipërfaqësor dhe me shumë pak detaje. Në këtë raport thuhet se ka pasur bashkëpunim me OJQ dhe KVRL, por cilat kanë qenë bashkëpunimet dhe aktivitetet e përbashkëta ne nuk i dimë?

Mandej nëse ka mundësi për ta sqaruar shumën e 600 mijë eurove janë ndarë apo është premtuar të ndahen nga ana e KE për stadiumin ndihmës të qytetit, sepse në raport nuk është qartësuar mjaft mirë dhe është thënë se nga KE ndahen 600 mijë euro?

Ndërsa te Teatri i qytetit e kemi problemin e pagave të punëtorëve dhe në raport thuhet se Teatri nuk funksionon mirë për shkak të disa problemeve, por një ndër problemet kryesore është edhe mos rregullimi i çështjeve të pagave. Na intereson për ta ditur se çka është ndërmarrë? Cilat masa janë ndërmarrë për rregullimin e kësaj çështje?

Ramiz Ramdani- unë së pari e kam një vërejtje edhe për zv/kryesuesin i cili po e respekton rregulloren, por do ta kisha vlerësuar shumë sikur t'ia kishte ndërprerë fjalën

edhe kryetarit! Sot është një ditë e veçantë dhe kujdesshëm të punojmë, sepse nuk ka nevojë për stërzgjatje, sepse në materialin e kemi lexuar në shtëpi!

Unë po filloj me Drejtorinë e Bujqësisë për të cilën u thanë fjalë të mëdha. Së pari nga DUMM në tabelën e shërbimeve të kryera figuron se janë dhënë 5 ekstrakte të shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Mirëpo unë e di se kompetencë e Drejtorisë së Bujqësisë është që t' i bëjë këto shndërrime dhe në asnjë vend nuk është cek në raport të kësaj drejtorie. Sa i përket buxhetit ose investimeve që kanë ndodhur në këtë drejtori do të isha shumë i lumtur, por edhe ju dhe të gjithë qytetarët me të vërtetë sikur të ishte një gjendje faktike si është prezantuar këtu! Mirëpo për fat të keq aq sa unë kuptoj dhe në detale si e kam analizuar mendoj se Qeveria Komunale dhe kryetari nuk e ka pasur bujqësinë prioritet. Të gjitha subvencionet të cilat kanë qenë të planifikuara kanë qenë të pjesshme të realizuara. Projekti i mbjelljeve pranverore kanë qenë të planifikuara 40 mijë euro, janë realizuar 31 mijë euro. Projekti për makina mjelëse kanë qenë të planifikuara 15 mijë euro janë realizuar 10 mijë e 50 euro. Projekti për serra kanë qenë të planifikuara 20 mijë euro, janë realizuar 16 mijë euro, për mbjellje vjeshtore kanë qenë të planifikuara 50 mijë euro nuk është realizuar asnjë cent. Projekti për ngritje të pemishteve kanë qenë të planifikuara 15 mijë euro nuk është realizuar asnjë cent. Do të thotë në fakt këto janë subvencione gjysmake. Te investimet kapitale, sinqerisht e mbështesë atë numrin e ekspertëve në këtë drejtori, sepse 10 ekspertë në këtë drejtori është një potencial, por nuk guxon ajo drejtori me atë kapacitet të mbesë në atë gjendje si në vitin 2006, apo 2007 etj. Ta zëmë asgjësimi i qenve endacak nuk guxon të bëhet me këto kapacitete të bëhet si është bërë atëherë. Mandej makina mjelëse 10 mijë e 50 euro, duhet ndryshuar edhe qasjen nëse dëshirojmë që të kemi edhe rezultate. Unë mendoj se drejtorja duhet të ketë parasysh projektin e ujitjes e cila do të kishte përmasa të gjëra të Anamoravës dhe do ta ndryshonte gjendjen.

Vërejtja e ime direkte për Drejtorinë e Bujqësisë është që në vend se të kërkojë mobilizim, në vend se të kërkojë mbështetjen tonë ajo më shumë po i kamuflon raportet duke e paraqitur edhe participimin e fermerëve dhe investimet e ministrisë dhe më duket edhe në pjesë e Komunës së Parteshit. Unë mendoj se më mirë do të ishte që të kërkojë mbështetje prej neve.

Nevzad Rushiti- unë e përshëndes këtë raport të drejtorëve të cilin e mori përsipër kryetari për ta elaboruar, por unë i kam vërejtjet e mia. Te Drejtorja për Pronë dhe Kadastër, në Komitetin për Pronë ku jam edhe unë anëtarë kam kërkuar që të regjistrohet saktësisht prona publike, sepse unë jam ithtar i asaj që prona publike të ruhet gjithmonë dhe këtë e kemi kërkuar qysh në fillim të mandatit. Nga prona publike kemi kërkuar që të regjistrohet toka, banesat dhe lokalet. Këtu thuhet se është bërë regjistrimi, por nuk ka të dhëna të sakta se a është bërë apo jo? Një vlerësim i imi është se vetëm Drejtorja e Inspeksionit ka bërë një paradhënie të mirë kështu që ka dhënë statistikën e numrit të punëtorëve dhe vendin e tyre të punës. Mirëpo e kam vërejtjen time aty që 2 vite e më tepër 4 punëtorë janë me kontratë në vepër, kurse disa janë larguar, por ka qenë desh kryetari i Komunës të na japi një arsyetim pse disa janë larguar, kurse disa ende janë në punë?

Te Inspeksioni kryetari tha shumë gjëra, siç është ajo që Komuna e Gjilanit të jetë më e pastër, mandej të lirohen trotualet nga shkallët, nga ajo pjesa e tregtisë dhe atë që e tha Arianiti ajo qëndron, sepse ai treg duhet të hiqet dhe prej shumë gjërave të tjera.

Në disa raste kemi edhe rrugë të mbyllura nga rëra, gurë, tjegulla të cilat njerëzit nuk i fusin në oborr, por i lënë në rrugë dhe bëjnë pengesë për qarkullim të qytetarëve.

Te Drejtoria e Buxhetit një gjë nuk po kam mundësi për ta kuptuar. Pse nuk janë të dhënat sa tatim pagues në pronë, sa familje janë, sa janë të liruara dhe sa kanë obligim? Atje përqindja del 99.6%, por nëse është numri i madh nuk është ashtu.

Te Drejtoria e Shërbimeve Publike te tenderi për shenjzim horizontal dhe vertikal, nuk po e kuptoj se ky sinjalizim a duhet çdo vit të bëhet, apo duhet në një periudhë për 5-6 vite të bëhet? Ato duhet bërë patjetër dhe duhet të epen 120 mijë euro, por për shkak të reshurave brenda 6 muajve ose një viti nuk ekzistojnë më! Për mua ky është një harxhim i paarsyeshëm të cilin gjë nuk duhet ta lejojnë njerëzit që janë kompetentë në atë drejtori. Sinjalizimin e dimë se kësaj here e ka punuar USAID-i dhe përsëri janë paraparë edhe 80 mijë e të cilat për mua është një shumë e pa vlerë dhe nuk arsyetohen pse bëhen ato shpenzime?

Ndërrprerja e rrugëve, asfaltit nga personat edhe fizik dhe juridik, (më këtë rast as Inspeksioni as Shërbimet Publike” nuk po e përcjellin këtë situatë dhe më pastaj një gropë ose një prerje mbetet 1 vit ose më tepër nuk rregullohet.

Zijadin Malqi- unë pjesën dërmuese të raporteve të drejtorive i kam lexuar, por edhe të kryetarit të Komunës. Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka dhënë një raport të shkurtër, por besoj se së shpejti brenda afatit ligjor, drejtoria do ta jep raportin financiar dhe aty do të shihen shumë më mirë edhe shpenzimet edhe të hyrat dhe obligimet të cilat mbesin do të shihen atje. Sipas sektorëve të cilat janë në raport dhe për tatimin në pronë ka qenë mirë që në raport të përfshihet saktësisht numri i faturave të lëshuara gjatë vitit 2012 dhe ngarkesat të cilat janë bërë në ato fatura dhe në këtë mënyrë të bëhet një krahasim me inkasimin i cili është bërë. Gjithashtu kam vërejt edhe një shënim tjetër e që është 1397 objekte të reja në Komunën e Gjilanit gjatë vitit 2012. Mua më duket se është një numër shumë i madh dhe nuk e di a ka pasur mundësi të ndërtohen të gjitha ato objekte gjatë vitit 2012.

Te Sektori për Buxhet dhe Financa e kam vërejt që sipas vendimeve, ngarkesa për taksa komunale nga biznesi kanë qenë 300 e 60 mijë e 254 euro, të inkasuara 289 mijë e 231 euro, kurse të planifikuara kanë qenë 245 mijë euro. Sipas kësaj del se nuk ka qenë një planifikim realist i kësaj të hyre, sepse është diferencë e madhe në mes të asaj që është numri i vendimeve dhe asaj që është planifikuar.

Te Zyra e Prokurimit edhe atje në bazë të raportit shihet se gjatë vitit 2012 janë kryer 141 aktivitete të prokurimit, 108 me procedurë të hapur, kurse 33 me vlera minimale.

Në raport nuk figuron numri i aktiviteteve të prokurimit të cilat janë anuluar, nuk figuron as numri i ankesave të operatorëve ekonomik në organin shqyrtues të prokurimit me të cilin rast do ta kishim një numër tjetër. Mandej do të ishte e mirë të dihet se çka ka vepruar dhe si ka vendos organi shqyrtues i prokurimit publik.

Unë i kam edhe disa vërejtje edhe në lidhje me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sepse i kemi disa aktivitete të prokurimit të cilat nuk e di a është me fajin e drejtorisë që nuk i ofrojnë me kohë në Zyrën e Prokurimit, apo është faji i Zyrës së Prokurimit që nuk i shpallë, apo ku qëndron çështja? Kjo ndodh te mirëmbajta e rrugëve si te ajo verore dhe dimërore . Nuk e di si e shpjegon kryetari këtë që ende nuk kemi operator ekonomik për mirëmbajta dimërore të rrugëve, është një ftesë për kuotim, por fati që nuk pasur të reshura (borë) dhe kemi shpëtuar. Për këtë arsye bëhet planifikimi dhe këto parashihen shumë më herët, sepse duhet menduar se mund të ketë ankesa. Kam vërejt se ka ftesë për kuotim në vlerë prej 9995 euro, të cilat ftesa nuk janë të preferueshme. Këto ftesa me 9995 euro bëhen kur i shkruan një dorë dhe i sjell dhe jo 3 -4 operatorë.

Është një çështje tjerë të cilën nuk e kam kuptuar se çka do të thotë: studimi mbi nevojën e klubeve sportive, unë nuk mund ta kuptoj se çka është kjo studimi mbi nevojën e klubeve sportive, është një vlerë prej 9650 euro. Është një tjetër ; kompletimi i disa projekteve në kompletimin e infrastrukturës. Cilës infrastrukturë, duhet t' i dihet emri, a është për shkollë, objekt shëndetësor etj. Në fund te organet mbikëqyrëse, unë e di që Komuna e ka një operator të zgjedhur për mbikëqyrje, por ende shumë shërbyes civil bëjnë mbikëqyrje dhe sot e lavdëroi edhe kryetari dhe i dha mirënjohje edhe zv/kryetarit për mbikëqyrje të një projekti të tillë. Pse është zgjedhur kompania? Për këtë është dhënë vërejtje edhe nga auditori se mbikëqyrjet duhet t' i bëjë një kompani dhe ajo është e zgjedhur.

Këto ishin vërejtjet e mia me dëshiroj që t' i keni parasysh !

Shpresë Hajdari- unë do të koncentrohem te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, raporti i së cilës drejtori së pari duhet të shkojë në komitetin përkatës, mandej të vijë këtu dhe mos të stërzgjatet debatit shumë këtu. Unë uroj që orari i Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport të respektohet, sepse ky komitet çdo tre muaj e ka mbajtur nga një mbledhje. Gjithashtu e di më që nga qershori ka ardhur edhe drejtori i ri, prandaj ne kërkojmë që takimet t' i mbajtëm sipas orarit të cilin e kemi paraparë. Gjithashtu në raportin e përmbledhur do t' ishte mirë që të shënohet se sa punëtorë janë në këtë drejtori duke i ndarë për secilin sektor veç e veç. Këtë po e them se që nga qershori, 12 aktorë të rinj më nuk janë në listë të pagave dhe deri në fund të vitit aktorët janë pa paga. Ku është problemi i aktorëve?

Ka qenë desh të formohet në Këshillë Artistik, të cilin kompetencë e ka kryetari i Komunës që nga viti i kaluar, por i cili ende nuk është formuar? Pyetje e fundit, deri ku kanë arritur punët për ndërtim të bibliotekës?

Jehonë Hyseni- edhe unë pak fjalë për DKRS dhe së pari po filloj nga Biblioteka Rajonale, në raportin e së cilës drejtori figuron vetëm numri i përgjithshëm i librave të lexuara, gazetave dhe revistave, mirëpo nuk figuron sa është numri i tyre në bibliotekat e fshatrave?

Mandej kam një pyetje për drejtorin: “ a ka pasur vizita, në bibliotekat e fshatrave dhe si qëndron gjendja në fshatrat ku ekzistojnë këto biblioteka”? Sallat e leximit a janë funksionale sidomos në këto ditë dimri? Gjithashtu kam edhe një pyetje se a janë shpallur këtë vit lexuesit më të dalluar dhe cili ka qenë libri më i lexuar, sa ka qenë numri i regjistruarve (lexuesve) të rinj ? Në përgjithësi do të ishte mirë që të jetë i specifikuar ky numër për të gjitha biblioteka?

Jakup Bajrami- ne e dëgjuam një raport njëvjeçar për 12 drejtori, në të cilin raport kishte edhe anë pozitive, por natyrisht se me një raport aq voluminoz ka edhe ndonjë të metë.

Unë në përgjithësi i kam tri vërejtje, njëra prej tyre është te arsimi. Vizitat që po ndodhin në Shqipëri e të cilat po zgjasin nga një javë, unë jam i mendimit nëse kemi kompetenca si Komunë që të biem vendim dhe t' i anulojmë. Këtë duhet ta bëjmë, sepse nuk po bëhen për të mësuar diçka, por po bëhen vetëm sa për t' u argëtuar! Mandej po e theksoj se Shqipëria është shtet i të gjithëve, por nuk e kam të qartë Shqipëria a merr ndonjë iniciativë që nxënësit e tyre ta vizitojnë Kosovën? Këto ekskursione po bëhen më tepër për t' i bërë disa biznese dhe po bëhet një argëtim si shfrenuar i nxënësve.

Mandej te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe e Urbanizmit është një projekt “Gjilani 5” që të cilin projekt e kemi mbështet të gjithë kur kanë ardhur këto mjete nga Zvicra, kurse tash është duke u bërë shpërndarja e rrjetit. Mirëpo rruga “Pajazit Ahmeti”, ka qenë një ndër

rrugët më të mira në të cilën që 10 vite nuk ka pasur asnjë prerje, por tash është masakruar ajo rrugë dhe për këtë fajtor janë dy drejtoritë të cilat nuk kanë bashkëpunuar dhe nuk e kanë bërë kanalizimin dhe ujësjellësin në anën e kundërt, por kanë shkuar në anën ku pengohen më shumë qytetarët! Unë kam bërë ankesë dhe kam marrë përgjigje se këtë e ka bërë Urbanizmi, prandaj këtë problematikë duhet ta shqyrtojnë njerëzit kompetentë pse kjo ndodh kjo shëmti në këtë rrugë.

Mandej kam një vërejtje lidhur me trotualet të cilat janë bërë në rrugën qarkore prej rrugës Ferizajt deri në rrugë të Prishtinës, afër tregut të automjeteve nuk është bërë shtrirja e kabllos në anën e majtë ku është më lirë dhe ku ka mundësi të shtrihet ai kablo, por është bërë shtrirja në anën nga janë shtruar kubëzat. Edhe në këtë rast nuk është bërë një nikoqirllëk për të ardhmen dhe atë çka po ndërtojmë po e shkatërrojmë për ta rindërtuar edhe njëherë. Është mirë që kryetari i Komunës dhe drejtoritë që të kenë kujdes që në ato vende ku njëherë investojmë, mos të kthehemi prapa pas 5-6 muaj apo një viti!

Tahir Arifi- unë i kam dëgjuar të gjithë ata që folën sot dhe dëshiroj që të potencoj se raporti është një dokument të cilin e prezantoi kryetari para Kuvendit, por i cili është i hartuar mbi atë se çka ka ndodhur në vitin 2012 në Gjilan. Fokusimi do të duhej të ishte në atë që është paraqitur në raport dhe do të duhej të ishte a ka pasur mundësi të bëhej më shumë dhe a qëndrojnë ato që janë në raport dhe jo të lëshohemi në shumë gjëra e të cilat për mua janë triviale dhe të parëndësishme. Do të dëshiroj gjithashtu që në këtë Kuvend, pozita asnjëherë të mos e luaj rolin e avokatit, ashtu siç opozita mos e luaj rolin e prokurorit. Ne duhet ta kryejmë punën tonë të shohim cilat punë janë bërë mirë dhe cilat nuk janë bërë mirë? Ju e pat se në prezantimin e kryetarit se së paku për dy drejtori, vërejtjet ishin tepër serioze. Do të thotë ekzekutivi ka qenë edhe vetë kritikë për punën e vetë. Do të fokusohem pak te Drejtoria e Kulturës. Ne kemi biseduar për Flakën e Janarit në KPP dhe është biseduar së paku në dy mbledhje. Është e vërtetë se këtë raport që e ka paraqit kryetari në nuk e kemi pasur në komitet, por të gjithë e dini, apo nuk e dini që ne e kemi pasur “Flakën e Janarit” këtë muaj, të cilën porsa e kemi përfunduar dhe DKRS ka qenë shumë e angazhuar në këtë aktivitet.

Teatri- përjashtuar Teatrit Kombëtar të cilin e mbikëqyrë Ministria e Kulturës, pavarësisht problemeve që janë në Teatrin e Gjilanit, përsëri Teatri i Gjilanit funksionon më së miri në Kosovë. Është e vërtetë se janë larguar nga muajit qershor nga lista e pagave aktorët e rinj të cilët ne i patëm pranuar në vitin 2008, por duke besuar se Teatri do të jetë institucion i Komunës dhe Ministrisë së Kulturës, por ndodhi ajo që ju e dini.

Me ligjin e ri mbi Teatrin, Ministria e Kulturës iu a ka shit teatrot komunave dhe realisht duhet të rishikohet edhe njëherë pozicioni dhe mënyra se si duhet të funksionojë teatri në të ardhmen.

U fol shumë për arsimin, por do të dëshiroja t’i them pak fjalë dhe problemi kryesor në arsim nuk janë këto probleme teknike që ne i kemi përmend. Kemi arrit të rregullojmë diçka çka ka qenë në kompetencën tonë për të rregulluar diçka në sferën e arsimit, por problemi kryesor në arsim është sistemi i arsimit. Këtë nuk e ka bërë Komuna dhe unë besoj se me këtë pajtohen të gjithë kolegët e mi që punojnë në arsim. Ne kemi problem me sistemin, ka filluar një sistem të cilin nuk e di si quhet i cili është marrë diku në Evropë për të cilin duhet ngritur zërin dhe duhet thënë se është dëshmuar jo funksional për kushtet tona.

Këtë duhet ta bëjmë ne, nuk mund ta rregullojmë shumicën e problemeve për pa e rregulluar sistemin. U përmend numri i mungesave të arsimtarëve dhe nxënësve, të cilat

mungesa i kemi vazhdimisht, por nuk përjashtohen nxënësit, sepse ligji nuk po e na lejon t' i përjashtojmë nxënësit. Ne e kemi një komision të cilin e kemi themeluar në këtë Kuvend për të cilin kam qenë kundër edhe me emra dhe në atë komision as opozita nuk e ka ngirt zërin për këtë çështje.

Selim Selimi- para se t' ia japim fjalën kryetarit edhe unë do t' i them pak fjalë. Edhe unë në emër të komunitetit në këtë rast e falënderoj kryetarin për kontributin e dhënë për komunitetin turk, duke filluar nga zgjidhja e problemeve të arsimit dhe ajo e kulturës.

Problemi i arsimit në gjuhën turke ka fituar një tretman më të mirë dhe siç ishte në raport tash ekzistojnë dy shkolla fillore dhe një e mesme në gjuhën turke.

Mirëpo tash është arrit që të jetë edhe një koordinator për paralelet turke. Gjithashtu edhe në kulturë, për shoqatat dhe OJQ-të kanë marrë pjesë në Turqi dhe e kanë përfaqësuar Gjilanin dhe Kosovën me një Ansambël nga Gjilani, kurse shpenzimet janë mbuluar nga buxheti i Komunës. Gjithashtu desha ta falënderoj e TIKA edhe për investime që i ka bërë për Medresenë “Alaudin” e cila është një shkollë e veçantë dhe një falënderim i takon edhe TIK-ës Turke.

Me këtë po e përmbylli, kurse fjalën do ta ketë kryetari i Komunës.

Qemajl Mustafa- unë jam mirënjohës edhe për atë që e tha opozita dhe për atë që e thanë grupet që janë në udhëheqje në Komunë. Pavarësisht asaj që ka tejkalime dhe stërzmadhime në kuptimin e mungesave, por edhe glorifikimet nuk janë të mira kur dikush të lavdëron përtej asaj që ka qenë realizim.

Për hir të informacionit sa më real para publikut dhe të këshilltarëve të KK-së që unë nuk jam ndal në investimet kapitale e që do të duhej për ta përplotësuar këtë raport të përmbledhur, sepse përceptazi duke ikur nga sektori në sektor, unë e kam thënë diçka edhe për ato investime. Po ia përkujtoj grupit në opozitë, por dhe të tjerëve që në Komunë kanë ndodhur jashtëzakonisht zhvillime të mëdha pozitive gjatë vitit 2012. Ato kanë qenë ose vazhdimësi e vitit 2011 ose kanë filluar dhe përfunduar këtë vit ose vazhdojnë.

Biblioteka Rajonale është një kontribut i jashtëzakonshëm i imi personal i drejtorëve dhe i atyre që e kanë menaxhuar Komunën gjatë vitit 2011 dhe e kanë nis si rezultat i asaj pune vetëmohuese, kushtimisht po e them 24 orë në ditë, ka filluar ai investim i mirë dhe i madh në Komunë. Është stopuar, sepse ka probleme me punë kryesin! Probleme ka autoriteti kontraktues e që është Komisioni Evropian që është investitor me punë kryesin i cili është i pa disiplinuar për të cilin me kohë e kam sinjalizuar unë KE. Po i njëjti punë kryes e ka lënë edhe objektin e Drejtorisë së Policisë, por e ka finalizuar Shkollën e Bujqësisë që ia ka dhënë Autoriteti i Prokurimit Publik. Të vetëdijshëm se kemi të bëjmë me një punë kryes jo serioz e kemi vendos Omerin si zëvendës timin si ndërtimtar që ta monitorojnë për së afërmi dhe ia kemi dal që shkolla sot të jetë e realizuar, sepse nuk i ka lëshuar pe për asnjë moment. Këtu është edhe përgjigja në atë që e tha Zijadini pse diku, diku janë ende shërbyesit civil mbikëqyrës kur është kompania për këtë? Mirëpo këta mbikëqyrës janë atje ku ne kemi perceptuar që kompania nuk mund ndoshta të fokusohet më denjësisht te projektet e ndjeshme(por janë pa pagesë.)

Është Gjimnazi, z. Sadudin, është shkolla fillore të cilat i kemi inauguruar, Shkolla Bujqësisë që po inaugurohet, është Mirusha e cila ka progresuar jashtëzakonisht mirë, është ajo përroska Banja e cila është në përfundim e sipër, është ndriçimi publik, është oborri i Shkollës “Thmi Mitko” i cili inaugurohet nesër së bashku me USAID-in Amerikan.

Është një pjesë e parkut në Lagjen “Arbëria”, e përmenda nga KE është Gjimnazi i Vjetër, Konvikti dhe Shkolla Fillore në Cernicë. Është renovimi i QKMF-së në Bresalc, Palestra në Malishevë është në përfundim e sipër i cili është objekt kapital mbi 300 mijë euro.

Fillon edhe Shkolla Fillore në Kishnapole dhe në Shurdhan, Qendra “Don Bosko” ka filluar e cila është në funksion të rinisë dhe të edukimit në Komunën tonë. Mandej kemi investime të mira dhe të përhershme në Stadium të qytetit, por edhe në Palestrën sportive.

Stadiumi ndihmës e ngriti dikush janë ndarë ajo jo mjetet? Për këtë stadium edhe përfituesi ekziston dhe në pranverë fillon puna në stadiumin ndihmës i cili duhet të përfundojë diku në gusht ose shtator.

Edhe në komitet, z. Sadudini e tha ndërtimet e larta janë pa interes publik. Kjo është edhe më pak se neglizhencë, kjo është edhe më pak se non –sens, kur thuhet ndërtimet e larta në një qytet, ndërtime të planifikuara, me leje të ndërtimit me pëlqim urbanistik janë pa interes publik. Ne disa herë e kemi thënë edhe këtu dhe në komitete që imperativ i kësaj qeverie është që të vijnë investimet çfarëdo qofshin ato, por duhet të jenë të qëndrueshme dhe funksionale për vitet që vijnë. Te ndërtimet e larta është thënë shumë herë dhe është punë e njohur se të gjithë banorët paguajnë tatimin në pronë dhe të gjithë do t’i paguajnë taksat tjera kur bëhet biznes, por edhe shërbimet publike.

Mandej thuhet janë premtuar tri akse, ato janë ambicie të mia dhe tjetër është ambicia dhe tjetër është mundësia, por edhe në ndërkohë ka pasur pengesa financiare dhe këtë e kemi thënë botërisht dhe thash edhe në foltore se këto dy vite të fundit janë të mangëta sa i përket investimeve kapitale nga Qeveria, por janë shumë të mira nga dhuruesit. Ne hyrjen e Prishtinës, atë projekt e kemi bërë me kohë dhe e kemi paguar atë projekt dhe është projekt i paralogarit mbi 3 milion euro dhe nesër ia fillojmë po erdhën financat. Mirëpo për mua është aspekt luksoz rregullimi i hyrjes së qyteti karshi rregullimit të rrjetit të ujësjellësit, mandej rrejt kryesor i kanalizimeve në rrugët kryesore të qytetit. Ujëmbledhësit të cilët nuk i kemi, sepse kur ka reshje të mëdha ka grumbullim të ujërave.

Sa i përket “Gjilani 5” është një investim i madh kapital në shumicë investim nga Qeveria Zvicerane dhe ajo është bërë me punën tonë dhe ka zgjat shumë ka filluar më 2004 si proces dhe në secilin mandat është kryer një pjesë e punës dhe sot ka përfunduar, ai sot është në operim. Prerja e asfaltit është bërë, sepse janë duke u shpërndarë vijat distribuive nëpër qytet.

Qendra për Aftësim Profesional është një investim rreth 1 milion. Është bërë shumë më tepër punë se sa është thënë në këtë raport larg, shumë më larg punë dhe shumë më shumë punë se sa unë do ta them tash dhe që e kanë drejtorët në raportet e tyre.

U tha se për rini nuk është bërë asgjë? Çdo gjë që ka ndodh në DKRS dhe në rrethinën e kësaj drejtorie është pikë-pre me rininë. Çka është investim tjetër në sport dhe kulturë përveçse në rini? Çdo projekt të rinisë që ka ardhur në zyrat tona së bashku me drejtorinë e kemi shqyrtuar i cili ka qenë në dobi të rinisë dhe komuniteti e kemi financuar me ato mjete të cilat i kemi pasur në disponim.

Dikush i përmendi psikologët nëpër shkolla, por duhet ditur se nuk po kemi mundësi për të pranuar edhe personel për mësimdhënie, prandaj ka mbetur ajo puna e psikologëve edhe pse me njëfarë norme më duket se lejohen nëse 1 mijë e më tepër nxënës i ka shkolla. Mirëpo sido që të jetë dy psikolog janë të pranuar në Drejtorinë për Arsim dhe në rast të nevojave për identifikim të fëmijëve që kanë probleme të veçanta, ata janë aty dhe i shërbejnë nxënësve.

Kemi probleme me listën e pagave, sepse ju e dini që ekziston një kufizim strikt nga Qeveria, Ministria e Financave që vëllimi i parasë të kodit të mos lëviz për asnjë cent të mbetët ai që është dhe të manipulohet me kode të tjera. Ne me kod tjetër nuk mund të lëvizmi me përjashtim me mallra dhe shërbime dhe subvencione. Për këtë arsyeje edhe punëtorët teknik transferohen te kompanitë private, sepse është e vetmja mënyrë për ta liruar listën e pagave. U fol për 83 nxënës të pavlerësuar, por duhet thënë troç, u pa statistika janë 26 mijë nxënës në sistemin e arsimit në Gjilan dhe 83 pjesëtuar me 26 mijë e shihni se çfarë përqindje është ajo? Është neglizhuere është kurrfarë! Nxënësit mund të mos vlerësohet për shumë shkaqe! Nuk vlerësohet, sepse ndoshta nxënësi është i sëmurë ose është i padisiplinuar dhe nuk vejnë në shkollë etj.

A ka punëtorë të pa licencuar? Nëse quhen të pa licencuar për fat të mirë ata janë vetëm dy që kanë dalë prej Kolegjit "Gjilani" janë për fat të keq të një ministri e të një ministrie të papërgjegjshme të një mandati para vitit 2008 e cila ka lejuar themelimin e këtyre kolegjeve dhe i ka gënjyer kolegjet, sepse edhe atëherë ligji e ka thënë dhe e thotë edhe sot se nuk mundën kolegjet private të prodhojnë kuadro për edukim. Ne jemi tash në komunikim me ministrin dhe është konstatuar tash se plan-programi ka qenë i njëjtë dhe është konstatuar se 90% e arsimtarëve kanë qenë të njëjtë të cilët kanë ligjëruar edhe në Fakultet të Edukimit të Universitetit Publik, prandaj është vendosur që këta të diplomuar të kthen në dy-tri lëndë plotësuese në Fakultetin e Edukimit dhe të certifikohen me diplomën e fakultetit publik dhe të tejkalohet ky problem. Për neve këta janë të licencuar, sepse e kanë një diplomë.

Mësimi jo formal- është princip në menaxhimin e financave, sepse e tërë çka inkasohet prej çdo aktiviteti publik, së pari alokohet në xhirollogarinë e Komunës, kurse mandej distribuohet në drejtim të shkollave. Ata që mbajnë mësim atje do të duhej të kompensohen sipas orëve apo ashtu siç është në rregullore, por edhe jam i sigurt se arsimtarët të cilët mbajnë mësim atje edhe kompensohen.

Ne kemi marrë një vendim në këtë Kuvend që askush mos t' i ketë dy vende të punës për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike dhe për shkak se ka një numër të madh të njerëzve të diplomuar të pa punë.

Jam i sigurt se ndërtimet e larta i plotësojnë kushtet për banim, përveç aty ku ka tejkalime dhe unë nuk e marrë atë guxim që ta them se në raste të tejkalimeve i plotësojnë kushtet për banim. Në këtë rast le të brengosën ata që kanë bërë tejkalime, ne i kemi monitoruar, kemi mbajtur seanca të jashtëzakonshme më 2008 vetëm e vetëm që të jemi në funksion të dy gjërave: që të ndodhin investimet në Komunë dhe e dyta që ta depolitizojmë Komunën.

Arsimtarët kanë të drejtë për të mbajtur kurse private, por DA, duhet ta bëjë monitorimin e përhershëm dhe preciz dhe nëse ata arsimtarë janë korrekt, ne nuk mund t' i ndalojmë njerëzit, sepse dija shitet në botë gjithkund. Mirëpo kjo nuk guxon të jetë me detyrim dhe të keqpërdoret nga arsimtarët.

Ne po bëjmë përpjekje që me hapjen e Gjimnazit të ri në Gjilan, t' i tërheqim të gjithë nxënësit nga Zhegra, sepse atje mësimi nuk po mbahet qoftë për shkak të angazhimit jo të duhur të arsimtarëve, qoftë për shkak të kushteve të cilat janë jashtëzakonisht të këqija.

Pagesat e Teatrit- askush nuk e ka drejtuar Teatrin më mirë se Komuna e Gjilanit jashtë Teatrit Kombëtar i cili ka buxhet nga ministria. Deri në qershor të gjitha obligimet për paga i kemi kryer, por prej 4 qershorit i kemi hequr nga pagat (10) aktor të rinj. I kemi lënë të vjetrit, sepse disa janë afër pensionit dhe për shkak të një kontributi që kanë dhënë, por edhe kjo është gabim, sepse nuk lejohet me asnjë ligj për të dhënë pagë kot.

Në fund kryetari dha edhe shumë përgjigje të tjera lidhur me aktivitet kulturore në Komunë siç është “Flaka e Janarit” dhe investimeve që janë bërë në bujqësi si nga Komuna, por edhe nga dhuruesit e ndryshëm.

Selim Selimi- e falënderojmë kryetarin për kontributin e dhënë dhe për përgjigjet që i dha të gjithë këshilltarëve të Kuvendit.

Sadudin Berisha- unë e kuptoj rolin e kryetarit të Komunës, por nuk ka kuptim që kryetari ta ketë fjalën pesë fish më shumë se anëtarët e Kuvendit. Mandej është bërë një dukuri e keqe nuk e di kështu kush e udhëheq Kuvendin? A zyrtari i Administratës civile, apo njeriu i cili është i zgjedhur?

Ne dëgjuam përsëri kryetarin e Komunës për referimet që i bëri një nga një për të gjitha vërejtjet, por unë asnjë milimetër nuk lëvizi nga pozicioni im që e kam thënë dhe e kam deklaruar!

E dyta është mirë që gjatë diskutimeve të mos ironizohet dhe as mos të veprohet me inercion të diskutimeve të kujt do qoftë, sepse këto janë për interesa publike dhe jo për private!

Çështja e kualifikimit të gabuar në tërësi nga kryetari i Komunës merr pjesë vetëm një pjesë të diskutimit të shumicës së diskutantëve, në këtë rast edhe timin, kur është fjala te interesi publik, në këtë rast kur është fjala se a duhet të jetë interes publik ndërtimi i lartë apo jo?

Absolutisht po dhe ajo duhet të favorizohet. Projekti i LDK-së në fushën e ndërtimit për nevojat e banimit të qytetarëve do të duhej të jetë dhe do të jetë ndërtimi i lartë. Mirëpo jo ndërtimi i lartë mbi asetet publike, të cilat asete publike në masën më të madhe mungojnë në Gjilan. Dy objekte të cilat janë në përfundim të ndërtimit të tyre janë dhënë në tokë publike e cila tokë i mungon për nevojat e interesave publike qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Por edhe këto ndërtime bëhen në kundërshtim me vendimin e këtij Kuvendi të nxjerr në vitin 2011, sepse aty ka qenë desh të ndërtohet pjesa e administratës për nevoja të shërbimeve publike. Këtë ne e kemi gjykuar dhe do ta gjykojmë dhe nuk mund të thuhet se prej atyre marrim tatimin në pronë etj.

Asnjë fjalë nuk e dëgjuam se cilat janë efektet e kësaj administrate për vitin 2012 me vendimet mbi kushtëzimet e qytetarëve, a janë pozitive apo negative dhe pse edhe më tej mbetën në fuqi vendimet që janë kundërshtuar nga organet kompetente vetëqeverisëse. Asnjë fjalë nuk u tha se cili është efekti i kushtëzimeve të qytetarëve për ujësjellës dhe mbeturina etj. Për këtë arsyeje duhet të jeni shumë të përgjegjshëm

Qemajl Mustafa- do t’ i kisha thënë disi ndryshe Sadudinit, por nuk po e them, por po i them që të vijë ta konsultojë Planin zhvillimor urban dhe komunal dhe në te ke për të parë ku janë pikat në të cilat është secili zhvillim për interes publik. Edhe ku është qendra kryesore e QKMF-së edhe ku është ndërtesa e Komunës për të cilën po flet Sadudini, prandaj nuk është mirë vetëm të flasim! Është aty ku janë gjykatat dhe të gjitha ndërtimet janë me miratim të KK-së prej vitit 2008 e këndej (ndërtimet kolektive) janë me vendim të KK-së. Edhe në tokë private janë hartuar planet rregulluese, janë miratuar zonat, janë destinuar për ato ndërtime, prandaj edhe po ndodhin ato ndërtime. Për ndërtimet tona në tokë publike dy vite së bashku kemi debatuar këtu dhe kemi marrë vendim pas vendimi dhe ia kemi filluar atyre ndërtimeve, prandaj është e pa vend sot të thuhet këto kanë ndodhur pa vendim të KK-së!

Po e ripërsëris, Plani zhvillimor urban dhe komunal që është miratuar në fund të vitit 2008 nga kjo Ansamble i definon të gjitha makro-zhvillimet në Komunë dhe nuk kemi ikur prej asaj.

Efektet te kushtëzimet kam thënë disa herë, por duhet pasur vullnet dhe vesh për të dëgjuar dhe sy për të parë! Kam thënë disa herë këtu dhe kanë ardh informacione prej dy kompanive se efekti është tepër pozitiv. Te Higjiena e kemi 100% rritjen e inkasimit, prej 22-23 mijë euro, ka kaluar 43-45 mijë euro për muaj. Te Hidromorava është mbi 40%, por aty ka edhe humbje shumë. Ju do t' i keni këto informacione dhe në fund po e përmbylli duke iu falënderuar të gjithëve për kontributin dhe do të vazhdojmë për ta ndërtuar së bashku Komunën, sepse alternativë tjetër nuk kemi.

Selim Selimi- në fund kërkoj që të deklaroheni se kush është për aprovim të Raportit të kryetarit të Komunës për vitin 2012?

Aprovohet pika 2/ 4 e rendit të punës: **Raportit të punës të kryetarit të Komunës për vitin 2012**, me 17 vota të anëtarëve të Kuvendit, 13 ishin kundër dhe 3 abstenime

Seanca i përfundoi punimet në ora 14.45 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA